

SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI
n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku

PREDMET: Dostava Izvještaja sa predlogom Zaključka
NAPOMENA: Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine
PODNOŠILAC PREDMETA: Predsjednik Opštine
OBRAĐIVAČ AKTA: Služba predsjednika
PRILOG: Izvještaj sa predlogom Zaključka

Poštovani,

Na osnovu člana 99 stav 1 tačka 12 Statuta opštine Tuzi („Službeni list Crne Gore – opštinski propisi“ br. 24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Izvještaj o radu predsjednika, organa uprave i službi opštine Tuzi za 2020.godinu sa predlogom Zaključka o usvajanju pomenutog izvještaja.

KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT
Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

LËNDA: Dorëzimi i Raportit së bashku me Konkludim
VËREJTJE: Të përfshihen në rendin e ditës në seancën e rrallës së Kuvendit të Komunës
PARASHTRUESI I PROPOZIMIT: Kryetari i Komunës
PËRPUNUESI I AKTIT: Shërbimi i kryetarit
SHTOJCË: Raporti me propozimin e Konkludimit

I nderuar,

Në bazë të nenit 99 paragrafit 1 pika 12 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e Mali të Zi – dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Raportin e punës së kryetarit, organeve të administratës dhe shërbimeve të komunës së Tuzit për vitin 2020, së bashku me propozimin e Konkludimit mbi miratimin e raportit në fjalë.

S poštovanjem,
Me respekt,

PREDSJEDNIK – KRYETARI,
Nik Gjeloshaj



**MALI I ZI
KOMUNA E TUZIT**

KRYETARI I KOMUNËS

**RAPORT MBI PUNËN
E KRYETARIT,
ORGANEVE TË ADMINISTRATËS
DHE SHËRBIMEVE
TË KOMUNËS SË TUZIT
PËR VITIN 2020**

Tuz, mars 2021

I. HYRJE

Raporti mbi punën e kryetarit, organeve të administratës dhe shërbimeve të Komunës së Tuzit për vitin 2020 është hartuar në kuadër të dispozitave të nenit 58 paragrafit 1 pikës 12 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 99 paragrafit 1 pikës 12 të Statutit të Komunës së Tuzit të cilat parashohin dhe përcaktojnë obligimin e kryetarit të Komunës, që një here në vit, të paraqesë para Kuvendit dhe qytetarëve raportin mbi punën e vet dhe të organeve të administratës lokale. Në kuadër të principeve të transparencës dhe qasjes së lirë, Raporti do të paraqitet para përfaqësuesve të Kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Tuzit.

Gjatë përpilimit të Raportit, janë marrë në konsideratë çështjet e caktuara përmes ligjeve, akteve nënligjore dhe vendimeve komunale, të cilat paraqesin profilin normativ për punën e tyre, si dhe detyra të përcaktuara sipas planeve shtetërore dhe aksionale. Gjithashtu, gjatë qasjes së përpilimit të Raportit për vitin 2020, periudha prej 01.01 – 31.12.2020, kryetari i Komunës ka shqyrtuar raportet mbi punën e organeve të administratës lokale, që në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse të mbikëqyrë funksionimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha segmentet e saj.

Puna e kryetarit të Komunës, në periudhën raportuese, ka qenë e fokusuar në realizimin e obligimeve të cilat dalin nga funksionet e tij në punën orientuese dhe përshtatëse të organeve të administratës dhe shërbimeve publike, funksionin mbikëqyrës mbi punën e organeve të administratës lokale, përgjegjësitë për ekzekutimin e ligjeve, vendimeve dhe akteve të tjera të cilat i sjellë Kuvendi si dhe realizimin e dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore dhe propozimeve të politikës reale në realizimin e funksioneve të vetëqeverisjes lokale.

Në periudhën raportuese është bërë punë e përkushtuar për konsolidimin e gjendjes financiare të Komunës, përmirësimin e mjedisit për zhvillimin e afarizmit dhe aktiviteteve për zbatimin e projekteve kapitale.

Me vet paraqitjen e pandemisë që goditi të gjithë botën, e pashmangshme ishte paraqitja e virusit COVID19 edhe në Mal të Zi. Si hapi i parë i ndërmarrë nga Komuna e Tuzit bazuar në rekomandimet e Qeverisë së Malit të Zi, për të parandaluar përhapjen e virusit COVID19, u miratuan masa të ndryshme që duheshin respektuar, në mënyrë që sa më shpejt të jetë e mundur të kapërcehej situata në të cilën gjendeshim në atë kohë. Bazuar në ato masa, shfrytëzuesve të buxhetit të komunës së Tuzit iu kërkua të ishin përgjegjës dhe të kursenin, ndër të tjera, u kërkua që të pezulloheshin pagesat e pjesës variabile të pagës dhe të gjitha kompensimet buxhetore për punën. Gjithashtu, u formua Ekipi komunal për mbrojtje dhe shpëtim brenda udhëheqësisë të komunës së Tuzit, përfaqësuesit të Drejtorisë për situata emergjente të MPB, komandantit të stacionit të policisë në Tuz, sekretarit të Kryqit të kuq të qytetit në Tuz dhe drejtorit të shpk „Komunalno – Komunale”.

Mbrëmja e papritur dhe e paparashikuar e 23 marsit 2020, natën kur Komuna e Tuzit mori statusin e karantinës dhe mbrëmja kur fillon lufta më e madhe e kësaj treve kundër virusit aktual! Komuna e Tuzit është komuna e vetme në Mal të Zi që ishte në izolim total nga data 24.03.2020 deri më 14.04.2020 ku qytetarëve të kësaj komune u shpallë izolimi total bazuar në rritjen e numrit të personave të infektuar në këtë territor. Atë mbrëmje, në seancë, Trupi koordinues nacional për sëmundjet infektive mori një vendim për të mbajtur popullin e komunës së Tuzit në shtëpitë e tyre me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të qytetarëve dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të virusit korona. Qëllimi ishte të parandalohej përhapja e përsheptuar e virusit, të cilin shërbimet epidemiologjike regjistruan gjatë ditës dhe alarmuan për nevojën e takimit dhe nevojën për sjelljen e vendimeve të shpejta që u morën atë mbrëmje. Instituti i shëndetit publik njoftoi atë mbrëmje rezultatet e të infektuarve, dmth. nga 34 mostra të testuara atë ditë, 18 ishin pozitive, nga të cilat 15 ishin nga Tuzi. Duke pasur parasysh se është një virus shumë infektues që përhapet shumë lehtë dhe mund të infektonte numër të madh njerëzish, situata u bë alarmante. Kryetari i komunës së Tuzit,

duke kuptuar seriozitetin e situatës, u bëri thirrje qytetarëve të kuptonin se që nga ajo ditë, të gjithë duhej të qëndronin në shtëpitë e tyre dhe të izoloheh për çka kërkoi Besën e tyre. I sigurt në banorët e trevës së vet, i sigurt se qytetarët e kësaj zone do të respektojnë atë që iu tha atë mbrëmje, beteja më e madhe kundër armikut të padukshëm dhe sfida më e madhe e komunës më të re në Mal të Zi filloi.

Me atë rast, nga data 25.03.2020, çdo lëvizje e qytetarëve u ndërpre; furnizimi i nevojave emergjente u krye nga vullnetarët e komunës, në ato ditë u testuan të gjithë personat që ishin në kontakt me personat e infektuar me virus. Qytetarëve u kërkohet disiplinë, në mënyrë që të fitonim betejën e fortë kundër virusit, të qëndronin në shtëpi, të kujdeseshin për familjet e tyre dhe vetëm në atë mënyrë arritëm dhe shpëtuam Malësinë. Në këtë drejtim, në të gjitha rrjetet sociale si dhe përmes transmetuesve publik, janë dorëzuar telefonat kontaktues të Shtabit komunal për situata emergjente të Komunës së Tuzit. Qytetarët pranuan të gjitha masat e urdhëruara nga komuna dhe shteti, ata pranuan realitetin dhe qëndruan në shtëpi, përderisa ekipet komunale dhe policia kanë këmbëngul për të parandaluar përhapjen e virusit. Në ato ditë ishte heshtje në të gjithë zonën e Malësisë. Njerëzit iu përgjigjën Besës së kërkuar për të qëndruar në shtëpi duke kuptuar se situata ishte shumë serioze.

Tre javë karantinë totale për më shumë se 15.000 banorë duhej të çonte në një sistem të ri të funksionimit për secilën zonë për shkak të jetës së qytetarëve të komunës. Përballë shumë sfidave, e para prej të cilave ishte lufta kundër pandemisë COVID19, komuna duhej të reagoonte shpejt për t'iu përgjigjur situatës. Komunikimi me institucionin në nivel kombëtar, Qeverinë e Malit të Zi, Trupin koordinues nacional për sëmundjet infektive të Malit të Zi, Ministrinë e shëndetësisë, Ministrinë e ekonomisë, Ministrinë e bujqësisë dhe zhvillimit rural, bashkëpunimi me Qendrën Klinike të Malit të Zi, Shtëpinë e shëndetit Podgorica dhe Tuz, Kryeqytetin Podgorica dhe komunat e tjera ishte çelësi për tejkalimin me sukses të situatës.

Para së gjithash, Komuna e Tuzit formoi koordinatore prej dy personave brenda institucionit, përmes të cilëve koordinatorët e bashkësive lokale do të arrinin në mënyrë sa më të shpejt deri tek ilaçet, higjiena dhe nevoja ushqimore për foshnje dhe fëmijë të vegjël, nevoja mjekësore, ushqime të përditshme, bukë, plasmanin e prodhimeve bujqësore, etj. Shtabi komunal në bashkëpunim me bashkësitë lokale, në rrethana urgjente formoi koordinatorët e bashkësive lokale me një numër të caktuar të vullnetarëve bazuar në numrin e popullsisë së vendbanimit. Mund të themi se gjetëm mënyrën më të mirë për të shpërndarë atë që u duhej qytetarëve tanë me një grup të vogël njerëzish, të cilët ishin efikas dhe të gatshëm të ndihmonin. Vullnetarët luajtën një rol kryesor në proces, së pari sepse e dinin se ku ndodhej secila familje dhe së dyti kontributi i tyre ishte vetëmohues.

Çdo fshat kishte numër të caktuar vullnetarësh që ishin të gatshëm në çdo kohë gjatë atyre ditëve të vështira, pa orë pune. Atë mbrëmje, u takuam me të gjithë pronarët e furrave në territorin e komunës së Tuzit, me të cilët u ra dakord për furnizimin e gjithë zonës, çdo ditë me bukë, e të cilat menjëherë filluan me punë të pandërprerë dhe shpërndarje të bukës për të gjitha familjet. U emëruan koordinatore dhe vullnetarë nga vendbanimet dhe bashkësitë lokale të mëposhtme: Omerbozhaj, Vuksanlekaj, Dushiq - Lekaj, Vrane, Dheu i Zi, Vllanë, Narhelm – Dreshaj, Triesh, Cemi i Trieshit, Hot, Sukruq, Dinoshë, Llofkë – Pikalë – Selisht, Mileshe, Kshevë, Drume, Kojë, Rakiq dhe Tuz. Brenda këtyre bashkësive lokale, 163 vullnetarë gravitonin çdo ditë. U dorëzua numri i telefonit i të gjithë koordinatoreve, me ç'rast qytetarët patën mundësinë të telefononin përfaqësuesin e tyre në varësi cilës bashkësi lokale i përkisnin. Koordinatorët vinin në komunë çdo mëngjes për pajisje mbrojtëse si doreza, maska, dezinfektues dhe i furnizonte me karburant.

Komuna po përballëj me një sfidë të madhe, si të organizonte jetën e përditshme dhe nevojat për më shumë se 4.800 familje me mbi 15.000 banorë. Ishim të ballafaquar me një numër të madh të njerëzve të infektuar, duhej t'i jepnim një përgjigje adekuate COVID19, kur bëhet fjalë për numrin e të infektuarve, e në të njëjtën kohë nevojitej të mbronim shëndetin e koordinatoreve dhe vullnetarëve.

Shtabi emergjent kishte autorizimin për të organizuar funksionimin e të gjithë komunës gjatë karantinës në mënyrë që të plotësojë të gjitha nevojat e qytetarëve të saj. Kjo organizatë trekëndore funksionoi gjatë tre javëve të bllokadës / karantinës totale në komunë, ku ata u përgjigjeshin çdo ditë shëndetit dhe medicinës, ushqimit, nevojave për foshnje dhe fëmijëve, ilaçeve, furnizimit me karburant etj. Dita e punës gjatë karantinës do të zgjaste 24 orë, punë në bazë të orëve të pakufizuara të punës mbi baza vullnetare në shërbim të qytetarëve. Secili pjesëmarrës në këtë proces, koordinatorët, zyrtarët në komunë, vullnetarët kishin një distinktiv me emrin, mbiemrin dhe rolin në organizimin të lëshuar nga komuna si dhe secila makinë që operonte në komunë kishte leje të veçantë për qarkullim. Në asnjë kohë qytetarët nuk ishin pa ushqime themelore, por edhe pa mbështetje për nevoja të tjera jetësore, dhe kanë bërë që izolimin të ndihej sa më pak të jetë e mundur, të paktën kur bëhet fjalë për nevojat e qytetarëve për jetën. Meritë e madhe u takon vullnetarëve të komunës nga të gjitha bashkësitë lokale që ishin aty, pa përjashtim, për të siguruar ndihmë, për t'u përgjigjur nevojave dhe për të rrezikuar shëndetin e tyre me qellim që të ndihmojnë bashkëqytetarët e vet prandaj Komuna e Tuzit u është mirënjohëse pafundësisht, sepse pa ndihmën e tyre, ato ditë të vështira nuk mund të tejkaloheshin.

E gjithë ndihma për ushqimet themelore u çonte në ndërtesën e komunës dhe depot e dhëna në shfrytëzim, nga ku vullnetarët i shpërndanin ato nëpër familje. Zinxhiri i komunikimit dhe zgjidhja e shpejtë e nevojave funksionoi në mënyrë të tillë që qytetarët kishin mundësinë të kërkonin të nevojshmet, përmes koordinatorëve të BL, pastaj koordinatorët përmes personave të caktuar në komunë të cilët ishin emëruar për fushë të caktuar të cilët do të bënin listën e nevojave çdo ditë, pastaj nevojat sipas listës do ua shpërndanin koordinatorëve të BL. Kështu, gjatë atyre ditëve, Komuna e Tuzit u siguroi qytetarëve të saj pako ushqimore, vezë Pashkësh, pako Pashkësh, higjienë dhe ushqime për fëmijë, karburant për funksionimin e papenguar të vullnetarëve dhe themeloren bukën, gjatë tre javëve të izolimit. Gjithashtu, ndër më të rëndësishmit ishin të moshuarit, dhe ata që kishin të përshkruara ilaçe, të cilëve u përpoqëm të sigurojmë dhe shpërndajmë të nevojshmet çdo ditë dhe sa më shpejt ishte e mundur, në bashkëpunim me farmacitë dhe zyrtarët komunalë, ndërsa lista e këtyre shërbimeve përfshin më shumë se 12.000 barna të porositura.

Secila prej këtyre fushave të funksionimit gjithashtu kishte një grup Viber në të cilin koordinatorët nga komuna koordinonin aktivitetet e përditshme me koordinatorët e bashkësive lokale dhe vullnetarët. Telefoni i zyrës së komunës ishte gjithashtu në dispozicion për të gjithë qytetarët përmes së cilit kishin mundësi të informoheshin në lidhje me procedurat ose nevojat e tyre eventuale. Posta elektronike e komunës ishte mjeti kryesor si një komunikim i veçantë midis komunës së Tuzit dhe institucioneve përkatëse në nivel kombëtar, gjegjësisht me Trupin koordinues nacional për sëmundje infektive të Malit të Zi. Gjithashtu, posta elektronike ishte një mjet për sektorin privat që vazhdoi të funksiononte me kushte të veçanta përmes komunës, veçanërisht duke pasur parasysh që Komuna e Tuzit është një komunë kufitare me shtetin e Shqipërisë. Çdo të dytën ditë, kryetari i komunës shfrytëzonte kanalën e vet në Facebook për të informuar qytetarët mbi numrin e të infektuarve dhe për aktivitetet e komunës me raportet e përditshme. Qytetarët patën mundësinë që përmes profilit zyrtar të komunës, të bëjnë pyetje dhe morën informacione eventuale. Të gjitha informacionet dhe raportet nga terreni u transmetuan edhe përmes televizionin lokal „Boin”.

Instituti i shëndetit publik dezinfektoi të gjitha ambientet e punës dhe zonat e komunës së Tuzit, si dhe Shtëpinë e shëndetit në Tuz përderisa Shërbimi për mbrojtje dhe shpëtim i Kryeqytetit dezinfektonte çdo ditë ndërtesën si dhe rrugën kryesore të komunës. Gjithashtu, në bashkëpunim me udhëheqësinë e Komunës së Ulqinit, falë vullnetit të tyre të mirë për të na ndihmuar, nga ana e tyre u bë dezinfektimi i pjesëve më të ndjeshme, qendra e Tuzit dhe pikat nga ku furnizoheshin vullnetarët.

Shërbimi publik „Komunalno – Komunale” shpk në ato ditë ishte e gatshme dhe në detyrë, ata u bënë thirrje qytetarëve të ndihmojnë në ruajtjen e pastërtisë publike në një kohë kur e gjithë administrata lokale dhe vullnetarët janë në shërbim të ruajtjes së shëndetit personal dhe publik. Për këto qëllime, „Komunalno – Komunale” shpk siguroi sasi të mjaftueshme të qeseve najloni, të cilat u

dorëzoheshin vullnetarëve të komunës, me kërkesën për hedhjen e mbeturinave në qese, dhe më pas në kontejnerë, ose para hyrjeve të tyre nga ku do i merrte shërbimi i pastrimit.

Komuna, domethënë Shërbimi i policisë komunale dhe inspektionit komunal, çdo ditë, pa ndalur, në lëvizje dhe në detyrë, kontrollonte lëvizjen e qytetarëve. Kemi bërë thirrje qytetarëve përmes të gjitha rrjeteve sociale, si dhe në televizionin lokal, dhe në bisedat telefonike, që masat duhet të respektohen, ndërsa ata treguan gatishmëri të jashtëzakonshme për t'i respektuar ato masa.

Duhet të theksojmë se produktet bujqësore, e cila është dega kryesore në të cilën janë të angazhuar 80% e banorëve të komunës së Tuzit, gjithashtu janë distribuuar në treg. Çdo ditë, prodhuesit bujqësorë informonin personin i cili ishte përgjegjës për përpilimin e listës së prodhuesve të interesuar bujqësorë dy herë në ditë, të cilët, të shoqëruar nga policia komunale, kishin mundësinë të çonin prodhimet e tyre në tregun malazez. Gjithashtu, në komunikimin e përditshëm me ta, ne bëmë numrin e përgjithshëm të produkteve bujqësore të shitura ose të mbetura. Për të mundësuar më tej zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë, Shtabi operativ mundësoi kalimin e cisternës nëpër komunën e Tuzit, e cila mundësoi furnizimin me karburant të pompës për ujitje të pronave bujqësore në këtë komunë, kurse është organizuar edhe distribuimi i plehrave duke shfrytëzuar furnizimet e farmacive bujqësore në Tuz. E njëjta procedurë u ndoq kur bëhej fjalë për shpërndarjen e mundshme të foragjereve si dhe sanës për bagëtinë. Gjatë atyre ditëve të izolimit, kishte veterinerë në detyrë dhe një klinikë veterinare që kryente të gjitha shërbimet për nevojat e blegtorëve në territorin e komunës. Gjithashtu, u përcaktuan farmacitë bujqësore, të cilat ato ditë furnizonin prodhuesit bujqësorë me përgatitjet e nevojshme në mënyrë të tillë që fermerët të thërrisnin farmacitë e autorizuar bujqësore, të porosisnin ato të domosdoshmet dhe të njëjtat farmaci produktet e porositura i dorëzonin në adresën e shtëpisë së qytetarëve.

Një respekt dhe vlerësim i madh në ato ditë shkoi për stafin mjekësor të Shtëpisë së shëndetit në Tuz, të cilët ishin në komunikim të vazhdueshëm me Shërbimin e policisë komunale dhe inspektionit komunal të komunës së Tuzit. Na informonin për çdo ndryshim, kishim marrëveshje për çdo rast që ishte për ndërhyrje mjekësore. Gjatë masave të karantinës, gratë shtatzëna në komunën e Tuzit u lejuan të kryejnë nevojat e tyre private dhe ekzaminimet përmes spitalit privat „Codra”, ndërsa fëmijët u lejuan të bënin vizitat e tyre dy herë në javë tek pediatri në Shtëpinë e shëndetit në Tuz. Pacientët e onkologjisë kishin një kujdes të veçantë në bashkëpunim me Entin për mjekim urgjent. Tjetri shërbim shëndetësor i realizuar me institucione shëndetësore merrej me pacientë të onkologjisë në Qendrën klinike, çdo qytetar i Tuzit, me këto nevoja, fillimisht siguronte testin negativ për COVID19, për të cilin kujdesohej Instituti i shëndetit publik, dhe më pas kishin mundësinë për të vazhduar me terapinë e vet. Pacientët në kimioterapi kishin mundësinë të merrnin terapinë e tyre në Shtëpinë e shëndetit në Tuz me marrëveshje paraprake për datën dhe kohën e kimioterapisë.

Organizimi i biznesit të ndërmarrjeve në Tuzi bëhej në atë mënyrë që biznesmenët që veprojnë në territorin e komunës së Tuzit, por jo banorë të kësaj treve, u drejtuan Shtabit operativ me një kërkesë për tu mundësuar punën. Në konsultim me Institutin e shëndetit publik të Malit të Zi, u përcaktua se është e mundur të plotësohen kërkesa të tilla me orë të kufizuara pune, nga 06:00 deri në 10:00. Sipërmarrësit do t'i drejtoheshin komunës së Tuzit me një kërkesë nga e cila do të merrnin konfirmim se punonjësit e asaj kompanie biznesi nuk janë banorë të komunës së Tuzit dhe me të cilët do të ishte e mundur të qëndronin në ambientet e punës / depot / magazinat e tyre në periudhën e specifikuar. Po ashtu, u bë blerja e mishit nga thertoret e vendosura në territorin e komunës së Tuzit, si dhe blerja e qumështit nga blegtorët nga territori i kësaj komune.

Komuna ka kapacitet për të përballuar sfidat kurse me bashkëpunim të mirë me institucionet kompetente, gjithëka është e mundur, duke pas parasysh se ishim në komunikim të përditshëm me përfaqësuesit e Qeverisë së Malit të Zi dhe Trupit koordinues nacional për sëmundjet infektive kështu që bashkëpunimi u tregua i suksesshëm. Qeveria e Malit të Zi pozitivisht përgjigje çdo kërkesë të komunës, para së gjithash, me prokurimin e produkteve ushqimore themelore për qytetarët tanë, pastaj për nevojat e fëmijëve, prodhuesve bujqësorë dhe blektorëve si dhe kërkesave të tjera.

Mbështetja erdhi nga e gjithë bota, duke filluar nga momenti kur kryetari i Trupit koordinues nacional inkurajoi qytetarët e Tuzit atë mbrëmje, duke thënë se ata nuk do të mbeten vetëm sepse Kryeqyteti dhe institucionet kompetente shëndetësore, Qeveria dhe e gjithë Mali i Zi janë me ta. Treva e Malësisë dhe Komuna e Tuzit kishin çdo lloj mbështetje zyrtare dhe joformale nga shteti dhe qytetarët. Mjete financiare dhe ndihma ushqimore komunës së Tuzit i erdhën nga Qeveria dhe institucionet shtetërore, firmat, kompanitë lokale dhe shtetërore, shoqatat, institucionet, organizatat humanitare, subjektet politike, OJQ-të, individët, diaspora nga vendet evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilët paguan mjete të konsiderueshme në llogarinë e komunës, pa apel për ndihmë, për të treguar se ata janë me qytetarët e vet. Në lidhje me këtë, çdo donacion u publikua në faqen e Facebook-ut të Komunës. Duhet të konstatojmë se shumë prodhues bujqësorë nuk kanë pasur mundësinë të shesin prodhimet e tyre prandaj prodhimet sikurse janë marule, qepë, qumësht, djathë, vezë, kos dhe kanë vendosur t'i japin falas vendasve të vet. Donacionet vinin gjithashtu nga ndërmarrjet që prodhonin qese, dezinfektues, higjienë personale, pajisje për vullnetarët (maska, doreza), ndërsa kompani të tjera, institucione, OJQ siguruan ushqim falas, shishe qumështi, sanë për bagëti etj. Disa kanë lëshuar objektet e tyre të magazinimit për qëllime të këtij karakteri dhe ne duhet të pranojmë se iniciativa ishte gjithëpërfshirëse dhe për të gjithë komunitetin pa dallime dhe pa diskriminim. Ky ishte rasti i vetëm kur komuna ishte ajo që ligji e njeh si shërbim i qytetarëve, por gjithashtu qytetarët u ofronin shërbime banorëve të tyre.

Komunën e Tuzit në ato ditë e vizituan Presidenti i Malit të Zi, Z. Millo Gjukanoviq, drejtori i Qendrës klinike, Dr. Jevto Erakoviq dhe drejtori i Qendrës emergjente njëkohësisht anëtar i Stafit mjekësor të krizave, Dr. Nermin Abdiq. Ata analizuan situatën e atyre ditëve, ndërsa Presidenti Gjukanoviq theksoi se drejtpërdrejtë ka pas dëshirë të tregoj respekt për punën e Komunës në situatën e krijuar, për vullnetarët dhe qytetarët duke u dakorduar që bashkërisht të përcjellim situatën që ky model suksesi në luftën me virusin të jetë shembull edhe për të tjerët.

Pas kërkesës së kryetarit të komunës së Tuzit, për zbutjen e masave të izolimit për banorët e Tuzit, Trupi koordinues nacional për sëmundjet infektive, më 14.04.2020, miratoi masa të reja zbutëse ku vetëm njërit anëtarë të familjes i lejohej dalja nga objekti i banimit, u lejua puna e farmacive dhe objekteve ku bëhej tregtia e ushqimit, pijeve, produkteve higjienike, etj., u lejuan fermerët të kryenin punë bujqësore në pronën e tyre të fermës nga ora 05 deri në orën 20, me përdorimin e detyrueshëm të pajisjeve mbrojtëse personale dhe sigurimin e distancës. Ndërsa vazhdoi ndalimi i: largimit nga objekti i banimit çdo ditë pune nga ora 3 pasdite deri në 5 të ditës tjetër dhe largimi nga territori i komunës së Tuzit.

Qytetarët e komunës së Tuzit respektuan maksimalisht masat e miratuara, duke treguar kështu me shembull se si disiplina dhe përgjegjësia çojnë në zbutjen graduale të masave. Në këtë drejtim, më 21.04.2020, Trupi koordinues nacional për sëmundjet infektive hoqi ndalimet speciale për komunën e Tuzit, dhe në atë drejtim, komuna iu nënshtrua masave sikur komunat e tjera në Mal të Zi.

Qytetarët e komunës së Tuzit treguan seriozitet në lidhje me këtë problem, ata ishin shumë të disiplinuar, ata treguan sjellje të civilizuar dhe kujdes për trevën dhe të ardhmen e komunës sonë. Respektimi i masave që u vendosën atë natë marsi tregoi se, rastësisht të mos ishte vepruar në atë mënyrë, numri i të infektuarve do të ishte mbi 200. Çdo herë treva jonë, në kohë të vështira, ka treguar faqen e bardhë.

Rekomandimet e të gjitha institucioneve përkatëse u respektuan dhe i gjithë komuniteti arriti të funksionojë në një situatë të ndalimit maksimal të lëvizjes për qytetarët. Duke pasur parasysh se situata ishte e tillë që kërkonte një reagim nga të gjithë ne si komunitet, kryetari i komunës së Tuzit kërkoi Besën nga qytetarët e tij sepse Besa është diçka që është karakteristike për njerëzit e kësaj treve, dhe është një fjalë që është e natyrshme në traditën tonë dhe të gjithë janë të vetëdijshëm për peshën e saj. Pikërisht ky lloj i reagimit dhe Besa ndihmoi qytetarët të kuptojnë rëndësinë e momentit dhe të qëndrojnë në shtëpitë e tyre. Nuk është e lehtë të kalosh nga liria në izolim, por shëndeti është diçka me të cilën askush nuk mund ose nuk duhet të luajë sepse është përgjegjësia e të gjithë neve.

Kuvendi i komunës së Tuzit me Vendimin mbi masat për zbutjen e pasojave financiare të krijuara për shkak të pandemisë së COVID-19 ka përcaktuar masa të cilat kanë për qëllim të zbusin pasojat financiare në Komunën e Tuzit të dala për shkak të COVID-19. Me qëllim të përkrahjes së bujqësisë në territorin e Komunës së Tuzit, janë ndarë 100.000,00 euro shtesë, për program për magazinimin e tepricave të prodhimeve bujqësore. Gjithashtu, Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit ka: liruar të gjithë personat fizik nga tatimi në truall për vitin 2020, shtyrë pagesën e mbitatimit në tatim mbi të ardhurat personale për periudhë prej 4 muajsh, shtyrë pagesën e tatimit në patundshmëri për këstin e parë prej më 31.08.2020, e për të dytin deri më 30.11.2020; shtyrë pagesën e kompensimit mujor për pajisje komunale të truallit ndërtimor të gjithë investitorëve që kanë lidhur kontrata për pagesa në këste mujore për periudhën 3 mujore; liruar nga pagesa e kompensimit për përdorimin e objekteve tregtare, të cilave u sigurohet qasje nga rruga komunale për një periudhë prej 4 muajsh; pezulluar të gjitha masat e pagesës së detyrueshme në afat prej 4 muajsh; liruar nga pagesa e taksës lokale komunale të përcaktuar në bazë të nxënies së sipërfaqes (kopshte veror, kopsht i mbyllur dhe objekte të tjerë lëvizëse) për periudhën 4 mujore dhe liruar nga pagesa e kontributit të anëtarësimit në organizatën turistike për vitin 2020.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve kemi aplikuar për Çmimin PA, çmim ky në nivel rajonal për inovacionin social. Komuna e Tuzit ka fituar çmimin për administratën publike për Ballkanin Perëndimor për vitin 2020. Western Balkans Public Administration Awards 2020 iniciativat të cilat i ka inicuar ReSPA Regional School of Public Administration dhe OECD/SIGMA me qëllim që të përmirësojë iniciativat e menaxhimit dhe të përkrahin vendosjen e sistemeve të qëndrueshme të administratës lokale në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Çmimet u dhanë në disa fusha dhe kishin të bënin me reagimin e institucioneve në krizën e shkaktuar nga COVID19. Planifikohet që Komuna e Tuzit, brenda këtij çmimi, të hartojë një plan për veprim në situatën e krizës COVID19, i cili do të ketë një ndikim rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Në këtë pikëpamje, kemi kënaqësi që komuna jonë e ka fituar këtë çmim në fushën e cila ka të bëjë me inovacionin shoqëror. Në mënyrë të veçantë u falënderohemi organizatorëve. Duam të theksojmë edhe me këtë rast se si shërbim i qytetarëve dhe si vetëqeverisje lokale jemi shumë krenar për këtë çmim, krenarë me koordinatorët tonë, vullnetarët, partnerët dhe sponsorët, e mbi të gjitha me qytetarët e Komunës së Tuzit. Ky çmim është mirënjohje për tre javë të karantinës, fuqinë, bashkësinë dhe përgjegjësinë të cilën e kemi treguar si komunitet.

Mund të themi se nuk ishim të vetëdijshëm për situatën me të cilën përballëshim derisa ajo nuk ka përfunduar. Besojmë se bashkëpunimi i ngushtë i kryetarit të komunës dhe përfaqësuesve të tjerë me bashkësinë lokale dhe vullnetarët e ka sjellë komunën më afër si një institucion për qytetarët. Virusi Corona ka treguar se ne mund të jemi të disiplinuar, tolerantë dhe empatikë ndaj njëri-tjetrit. Treva e përbëjnë njerëzit, jo individët, në një botë që është bërë „globale” është e rëndësishme të ndiejmë se bashkëtojmë me njëri-tjetrin, interesi i komunitetit duhet të jetë gjithmonë i pari për të gjithë, është konfirmuar se kemi nevojë njëri-tjetrin dhe se duhet të respektojmë njëri-tjetrin dhe se gjithmonë do të jetojmë në bashkësi.

II. FUNKSIONI NORMATIV

Kryetari i Komunës, me qëllim të realizimit të funksionit normativ, drejtoi punën e organeve kompetente të qeverisjes lokale dhe mori pjesë në përgatitjen përfundimtare të akteve që iu dërguan Kuvendit për miratim. Duke pas parasysh situatën e krijuar gjatë vitit 2020, janë mbajtur 4 seanca të Kuvendit të komunës së Tuzit, ku kryetari i komunës gjatë vitit, në pajtim me funksionin e tij normativ ka qenë propozuesi i akteve. Në lidhje me këtë, Propozimet e Vendimeve, konkludimeve dhe programeve të përgatitura dhe realizuara nga ana e organeve të vetëqeverisjes lokale të cilat janë përcjellë Kuvendit të komunës së Tuzit për ti vënë në procedurë janë:

- Propozimi i Programit të rregullimit hapësinor të komunës së Tuzit për vitin 2020;
- Programi i punës së SHPK „Komunalno/Komunale” për vitin 2020;
- Propozimi i Vendimit mbi kompensimin për punë të trupave të përhershëm dhe të përkohshëm të Kuvendit të komunës së Tuzit të themeluara me vendime të posaçme;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Kontratë mbi udhëheqjen e Klubit të futbollit „Deçiq”;
- Propozimi i Vendimit mbi verifikimin e Vendimit mbi përcaktimin e kompensimit për punë të organeve drejtuese dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar themelues i të cilave është Komuna e Tuzit;
- Propozimi i Vendimit mbi verifikimin e Vendimit mbi plotësimin e Vendimit mbi kriteret e hollësishme për shfrytëzimin e mjeteve të buxhetit rezervë aktual dhe të përhershëm;
- Propozimi i Vendimit mbi verifikimin e Vendimit mbi lartësinë, mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së kontributit të anëtarësimit në Organizatën turistike të Tuzit;
- Propozimi i Vendimit mbi miratimin e Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2019;
- Propozimi i Vendimit mbi verifikimin e Vendimit mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuara për bujqësi;
- Propozimi i Vendimit mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtjes së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024;
- Propozimi i Vendimit për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentit të natyrës „Kanjoni i Cemit” për vitin 2020-2025;
- Propozimi i Konkludimit mbi miratimin e Raportit mbi gjendjen e pronës së komunës së Tuzit për vitin 2019;
- Propozimi i Vendimit mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësim të plotë të patundshmërisë në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës katolike në Tuz, në pajtim me aktvendimin Gjeneral urbanistik të Tuzit;
- Propozimi i Vendimit për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e komunës së Tuzit;
- Propozimi i Vendimit për miratimin e Planit të objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Tuzit;
- Propozimi i Vendimit mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OJQ-ve në trupat punues;
- Propozimi i Vendimit mbi masat për zbutjen e pasojave financiare të krijuara në Komunën e Tuzit për shkak të pandemisë së COVID-19;
- Raporti i punës së kryetarit, organeve të administrates dhe shërbimeve të komunës së Tuzit për vitin 2019;

- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për lidhjen e Kontratës mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit, me sh.p.k. „Komunalno/Komunale” Tuz;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno/Komunale” Tuz;
- Propozimi i Vendimit mbi verifikimin e Vendimit mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuara për bujqësi;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Çmimoren e shërbimeve për grumbullimin dhe deponimin e mbetjeve komunale të „Komunalno/Komunale” Tuz SHPK;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Çmimoren e „Komunalno/Komunale” Tuz SHPK për tregun e gjelbër në Tuz;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Çmimoren për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave, për përdorimin e shërbimeve të automjeteve dhe makinave të punës, pastrimi i sipërfaqeve dhe marrja me qira e koshave për mbeturina, sipas kërkesave specifike të shfrytëzuesve të shërbimeve të „Komunalno/Komunale” Tuz SHPK;
- Raporti gjysmë-vjetor mbi të ardhurat e përgjithshme dhe shpenzimet e bëra totale, të shprehura në përputhje me klasifikimin organizativ, funksional dhe ekonomik;
- Propozimi i Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Vendimin mbi themelimin e Bashkësisë lokale „Traboin“, „Koja“, „Kshevë“, „Rakiq“, „Dheu i Zi“, „Drume“, „Dushiq – Lekaj“, „Dinoshë“, „Omerbozhaj“, „Narhelm-Dreshaj“, „Rranza e Sukes“, „Sukruq“, „Triesh“, „Vrane“, „Vllanë” dhe „Vuksanlekaj”.
- Propozimi i Vendimit mbi kompensimin vjetor për shfrytëzimin e hapësirave për objekte të paligjshme;
- Propozimi i Vendimit mbi Buxhetin e komunës së Tuzit për vitin 2021;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për qasjen në Marrëveshjen e kryebashkiakëve të komunave për klimën dhe energjinë;
- Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit në Programin vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale të SHPK „Komunalno/Komunale” Tuz për vitin 2021;
- Propozimi i Vendimit mbi kompensimin për pajisjen komunale të truallit ndërtimor;
- Propozimi i Vendimit mbi kompensimin për sanimin urban;
- Propozimi i Programit i rregullimit hapësinor të Komunës së Tuzit për vitin 2021;
- Propozimi i Vendimit mbi vendosjen ose ndërtimin dhe heqjen e objekteve ndihmëse;
- Propozimi i Vendimit mbi miratimin e Planit lokal akcional për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi dhe promovimin e barazisë për periudhën 2021-2023;
- Propozimi i Vendimit mbi miratimin e Strategjisë me planin akcional për punësimin të Komunës së Tuzit për periudhën 2021-2025;
- Propozimi i Vendimit mbi themelimin e Komisionit të etikës për zyrtarët dhe nëpunësit lokal të komunës së Tuzit;
- Propozimi i Vendimit mbi themelimin e Komisionit të etikës për përfaqësuesit dhe funksionarët e zgjedhur në vetëqeverisjen lokale;
- Propozimi i Vendimit mbi themelimin e Këshillit për të rinjtë e komunës së Tuzit;
- Propozimi i Vendimit mbi të ardhurat e funksionarëve lokal të komunës së Tuzit;

- Propozimi i Vendimit mbi të ardhurat e zyrtarëve dhe nëpunësve lokal të komunës së Tuzit.

Përkundër situatës me të cilën u përball Komuna e Tuzit me rastin e pandemisë gjatë vitit 2020, janë lidhur kontrata dhe marrëveshje të rëndësishme për këtë territor. Me kontratën mbi realizimin e programit Ndërtimi i infrastrukturës lokale të lidhur midis komunës së Tuzit dhe Administratës së punëve publike, janë realizuar disa projekte me rëndësi për territorin tonë, siç janë: Rregullimi dhe ndërtimi i këndeve për lodra për fëmijë, rregullimi i infrastrukturës lokale pranë kopshtit dhe shkollës fillore në Tuz, etj.

Kontrata mbi financimin dhe menaxhimin e klubit të futbollit „Deçiç” me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet në lidhje me financimin dhe transferimin e menaxhimit mbi këtë klub. Pastaj, Memorandumi mbi bashkëpunimin ndërmjet OJQ „Fëmijët e Malit të Zi” dhe komunës së Tuzit me të cilin përcaktohet bashkëpunimi me vetëqeverisje lokale në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë, si dhe kontrata mbi të drejtat e ndërsjella dhe detyrimet mbi bashkëfinancimin e Programit të punës OJQ „Karnevali-Koret” me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të këtyre dy institucioneve.

Kontrata mbi besimin e kryerjes së aktiviteteve komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale dhe mjeteve të tjera në pronësi të komunës së Tuzit, e lidhur midis komunës së Tuzit dhe „Komunalno - Komunale” shpk. Pastaj, kontrata e lidhur midis Komunës së Tuzit, „Komunalno - Komunale” shpk dhe „Deponija” shpk për ofrimin e shërbimeve të asgjësimit të mbetjeve komunale në deponinë „Livade” Podgoricë e cila rregullon të drejtat dhe detyrimet reciproke ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me shfrytëzimin e deponive për asgjësimin e mbetjeve komunale.

Kontrata e lidhur midis komunës së Tuzit dhe „Red Commerce” shpk me të cilën kontratë janë siguruar shërbime të magazinimit për shalqi dhe patate të prodhuara nga prodhuesit bujqësorë nga territori i komunës së Tuzit deri në rregullimin e çrregullimeve të tregut në mënyrë që të parandalohen humbjet që fermerët do të pësonin. Gjithashtu, kur bëhet fjalë për bujqësinë, u nënshkrua një Marrëveshje për bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë, e cila përshkruan kushtet brenda mbështetjes së blerjes së qumështit dhe pagesës së primeve të qumështit në nivel mujor.

Pastaj, u nënshkrua Marrëveshja me Sindikatën e të punësuarve në komunën e Tuzit, e cila e detyron punëdhënësin të paguajë shtesa dimërore për punonjësit në organet dhe shërbimet e komunës së Tuzit për vitin 2020, si dhe marrëveshja mbi bashkëpunimin me IP Qendra për ruajtjen dhe arkeologjinë e Malit të Zi me të cilën përcaktohet lloji i kornizës dhe kushti i bashkëpunimit të biznesit në përputhje me rregulloret. Gjithashtu, u nënshkrua kontrata për bashkëfinancimin e punës së programeve të organizatave sportive në vitin 2020, si dhe Kontrata për bashkëfinancimin e punës së programeve të organizatave sportive në vitin 2020 me klubin e futbollit „Deçiç” si marrës bazuar në Vendim për financimin e sportit.

Përveç Vendimeve të cilat janë miratuar në seancat e Kuvendit të komunës së Tuzit, gjatë kësaj periudhe janë sjellë edhe vendimet e mëposhtme:

- Vendimi për emërimin e Koordinatorit dhe Grupit punues për hartimin e Planit strategjik të zhvillimit të Komunës së Tuzit, detyra e të cilit është të mbledhë të dhëna dhe informacione në lidhje me gjendjen aktuale të zhvillimit të Komunës së Tuzit dhe të dhëna të tjera të nevojshme dhe t'i paraqesë ato te Grupi konsultativ për hartimin e Planit strategjik, hartimi i analizës SWOT dhe paraqitja e tyre pranë Grupit konsultativ për hartimin e Planit strategjik, përgatitja e versionit fillestar të kapitullit të Planit strategjik të zhvillimit, mbledhja dhe analizimi i komenteve nga Grupi konsultativ dhe bën ndryshimet dhe kryen detyra profesionale administrative dhe detyra të tjera për Grupin konsultativ;

- Vendimi mbi përcaktimin e përkohshëm të emërtimeve të vendbanimeve, rrugëve dhe shesheve në territorin e komunës së Tuzit me të cilin përkohësisht përcaktohen emërtimet e rrugëve në territorin e komunës së Tuzit;
- Vendimi mbi lartësinë e mjeteve buxhetore të dedikuara për financimin e punës së rregullt të organizatave femërore në subjektet politike në Kuvendin e komunës së Tuzit për periudhë 01.02.2020-31.12.2020;
- Vendim mbi lartësinë për punë në komision, këshillë dhe trup punues, të cilat themelon kryetari i komunës së Tuzit më të cilin përcaktohen kushtet, mënyra, procedura dhe lartësia e kompensimit për punë në komisione, këshilla dhe trupa punues të cilat themelon kryetari i komunës së Tuzit;
- Vendimi mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit me të cilën organizohet administrata lokale e komunës së Tuzit, themelohen organet e administratës lokale, shërbimet e veçanta dhe shërbimet të cilat kryejnë punë të përbashkëta dhe profesionale për nevoja të komunës, përcaktohet fushëveprimi i tyre dhe mënyra e punës, përcaktohen kriteret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e organeve të administratës dhe shërbimeve dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e administratës lokale;
- Vendim mbi ndarjen e bursave me të cilin ndahen bursat kandidatëve të cilët sipas propozimit të Komisionit për ndarjen e bursave kanë plotësuar kushtet nga Konkursët dhe kanë plotësuar kriteret nga Vendimi mbi burimin e studentëve në komunën e Tuzit, e të cilët kanë marrë pjesë në Konkurs për ndarjen e bursave të publikuar në tabelën publike dhe ueb faqen e komunës së Tuzit;
- Vendimi për organizimin e punëve të lidhjes martesore në territorin e komunës së Tuzit, i cili rregullon organizimin e çështjeve të martesës në territorin e komunës së Tuzit, përcakton lokalet zyrtare në të cilat do të kryhet martesa, etj.

Në kuadër të kompetencave të veta, kryetari i komunës ka sjellë aktvendimet e mëposhtme:

- Aktvendimi mbi emërimin e komisionit për identifikimin dhe ndarjen e gjatësisë së kabllave midis Kryeqytetit dhe komunës së Tuzit, detyra e të cilit është të identifikojë dhe ndajë gjatësinë e kabllave sipas përkatësisë territoriale midis Kryeqytetit dhe komunës së Tuzit, e cila do të mundësonte llogaritjen e veçantë të kompensimit për tubacionet, ujësjellësin, kanalizimet, furnizimin me ujë elektrik, telefonik dhe telegrafik;
- Aktvendimi mbi formimin e partneritetit lokal për punësimin, i cili është një organ këshillimor për administratën lokale në krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës lokale të punësimit dhe iniciativave lokale, të cilat do të inkurajojnë punësimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe kështu zhvillimin socio-ekonomik të komunës;
- Aktvendimi mbi emërimin e një personi përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin dhe përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit i cili do të koordinojë aktivitetet për zbatimin dhe përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit;
- Aktvendimi mbi formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore detyra e të cilit është të vlerësojë drejtpërdrejt dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në territorin e komunës së Tuzit, të cilët do të bëjnë procesverbal dhe të dorëzojnë kryetarit të Komunës dhe Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të Qeverisë së Malit të Zi;
- Aktvendimi mbi formimin e komisionit për udhëheqjen e ankesave me „13.Korriku – Plantacionet” SHA Podgoricë, detyra e së cilës është të zhvillojë negociata në mënyrë që të përcaktojë bazën reale për llogaritjen e taksës së pasurisë së paluajtshme dhe të përfundojë

procedurën administrative sipas deklaratës së regjistruar tatimore të tatimpaguesit të pasurisë së paluajtshme;

- Aktvendimi mbi krijimin e Grupit punues qëllimi kryesor i të cilit është të inkurajojë dhe përmirësojë pozicionin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësinë lokale përmes zhvillimit të programeve dhe infrastrukturës, e cila do të sigurojë mundësi të barabarta pa diskriminim;
- Aktvendimi mbi formimin e Grupit punues për përgatitjen e Propozimit të paketës së masave ekonomike me qëllim zbutjen e pasojave për ekonominë dhe qytetarët e Tuzit të shkaktuara nga pandemia e virusit COVID 19;
- Aktvendimi mbi emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit për propozimin e emrave të vendbanimeve, rrugëve dhe shesheve;
- Aktvendimi mbi për formimin e komisionit për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive nga Buxheti i Komunës së Tuzit të destinuar për financimin e organizatave sportive për vitin 2020;
- Aktvendimi mbi formimin e Grupit punues qëllimi kryesor i të cilit është të inkurajojë dhe përmirësojë pozicionin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësinë lokale përmes zhvillimit të programeve dhe infrastrukturës, e cila do të sigurojë mundësi të barabarta pa diskriminim;
- Aktvendimi mbi emërimin e personit për të marrë dhe vepruar sipas raportit të sinjalizuesit për të marrë dhe vepruar sipas paraqitjes së korrupsionit nga ana e sinjalizuesit;
- Aktvendimi mbi përcaktimin e personit përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Planit të integritetit – menaxherit të integritetit dhe Aktvendimi mbi formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të integritetit i cili do të mbledhë dhe analizojë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të administratës lokale të Tuzit, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut në bazë të së cilës u miratua edhe Plani i integritetit për periudhën 2020-2024;
- Aktvendimi mbi emërimin e Komisionit për ndarjen e bursave për vitin studimor gjegjësisht shkollor 2020/2021 si dhe Aktvendimi mbi emërimin e Komisionit për inventarizimin e pronave të komunës së Tuzit i cili është përgjegjës për inventarizimin e pasurive të patundshme, inventarit të vogël, kontabilimit dhe mjeteve financiare me të cilat disponon Komuna e Tuzit për vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, janë përcaktuar ushtrues të detyrës së organeve të administratës lokale, përderisa me konkurs janë emëruar dy sekretar të sekretariateve dhe ata të Sekretariatit për vetëqeverisje lokale dhe Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik. Me aktvendim është përcaktuar UD i Kryeadministratorit të komunës së Tuzit, UD së kryeshefit të Shërbimit të policisë komunale dhe inspektionit komunal, UD së sekretarit të Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale, UD së sekretares së Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural, UD së drejtorit të Administratës së të ardhurave lokale publike dhe UD së drejtoreshës së Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim.

Në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale, kryetari i komunës ka sjellë Vendimin e ri mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale, me të cilin janë themeluar organet e administratës lokale, shërbimet speciale dhe shërbimet që kryejnë detyra të përbashkëta dhe profesionale për nevojat e komunës. Në lidhje me këtë, u formuan 6 sekretariate, 3 shërbime profesionale dhe 2 shërbime speciale, të cilëve u është rregulluar fushëveprimi dhe mënyra e punës, përcaktohen kriteret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e organeve të administratës dhe

shërbimeve dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e administratës lokale. Me miratimin e Vendimit të ri mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit, aktivitetet e disa organeve të përcaktuara me Vendimin e mëparshëm u shfuqizuan, në këtë mënyrë ka ardhur deri tek përcaktimi i ushtruesve të rinj të detyrave dhe në lidhje me këtë me Aktvendim është përcaktuar UD së sekretarit të Sekretariatit për financa, UD së sekretarit të Sekretariatit për urbanizëm, UD së sekretares së Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural, UD së sekretarit të Sekretariatit për zhvillim ekonomik dhe UD së sekretares së Sekretariatit për pronë.

Gjithashtu, janë miratuar rregullore dhe udhëzime, siç janë Udhëzimi për veprimin e raporteve dhe regjistrimeve të raporteve të korrupsionit brenda komunës, si dhe mbrojtja e identitetit të personit që ka paraqitur raportin, duke rregulluar mënyrën e raportimit të brendshëm të korrupsionit dhe parregullsi të tjera, shqyrtimi i raporteve të pranuar të korrupsionit dhe parregullsi të tjera, detyrimi për të informuar personat që raportuan korrupsionin dhe parregullsitë e tjera për veprimet e ndërmarra, mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsionin dhe parregullsitë e tjera dhe çështje të tjera në lidhje me raportimin e brendshëm të korrupsionit dhe parregullsitë e tjera në komuna. Pastaj, Rregullorja mbi kushtet për shtyrjen e pagesës së kërkimeve tatimore dhe jo-tatimore, e cila përshkruan kushtet në të cilat tatimpaguesit mund t'i miratohet shtyrja e pagesës së tatimeve dhe jo-tatimeve të prapambetura.

Është sjellë Udhëzuesi për qasje të lirë në informacion në posedimin e Shërbimit të kryetarit të komunës me të cilin përcaktohet lloji i informacionit në shërbim të kryetarit të komunës së Tuzit, procedura për qasje në informacion, emri i personit të autorizuar për të vepruar sipas kërkesës për qasje në informacion, kostot e procedurës, mënyra e publikimit të Udhëzuesit dhe të dhëna të tjera relevante për ushtrimin e së drejtës për qasje në informacion në posedimin e Shërbimit të kryetarit të komunës, në përputhje me ligjin. Gjithashtu, u miratuan Raporti mbi aktivitetet në zbatimin dhe përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit, Raporti mbi zbatimin e Planit të integritetit si dhe është sjellë Plani i kuadrove për vitin 2020.

III. KRYERJA E PUNËVE TË ORGANEVE DHE SHËRBIMEVE TË ADMINISTRATËS LOKALE

Në periudhën e analizuar, nga 01.01.2020. deri më 31.12.2020, punët brenda kompetencave të administratës lokale u kryen nga organet e kësaj administrate, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj dhe Vendimin mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit.

Organet dhe shërbimet e administratës lokale kanë ekzekutuar ligje, rregullore të tjera dhe akte të përgjithshme, kanë përgatitur projektvendime dhe rregullore të tjera të cilat i sjellë Kuvendi dhe kryetari i Komunës, kanë kryer mbikëqyrje administrative, kanë kryer detyra profesionale dhe detyra të tjera që u janë besuar atyre nga Kuvendi dhe kryetari i Komunës, kanë vendos në procedurat administrative për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, personave juridikë dhe personave të tjerë, kanë mbajtur shënime publike dhe të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte të përgjithshme të organeve të administratës lokale dhe kanë kryer detyra të tjera në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera, si dhe detyra të administratës shtetërore të transferuara atyre me ligj ose të besuara me rregulloret e Qeverisë së Malit të Zi. Në përputhje me rregullat, organet e administratës lokale të Komunës, kryetarit i kanë dorëzuar raportet të cilat janë të paraqitura në faqet vijuese.

1. SEKRETARIATI PËR VETËQEVERISJE LOKALE

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, Sekretariati për vetëqeverisje lokale ka kryer detyra në lidhje me ekzekutimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të sjella nga Kuvendi i Komunës dhe kryetari i komunës së Tuzit, ka zgjidhur çështjet administrative dhe detyra të tjera brenda fushëveprimit të përcaktuar.

Gjatë kryerjes së detyrave brenda kompetencave të veta, Sekretariati bashkëpunoi me organet dhe shërbimet e tjera të komunës së Tuzit si dhe organet dhe shërbimet e komunave të tjera, në varësi të natyrës së punës dhe me organet shtetërore, institucionet, organizatat joqeveritare dhe qytetarët, në përputhje me ligjet për të drejtat dhe detyrat, Statutin e komunës së Tuzit dhe rregulloret e tjera pozitive.

Sekretariati për vetëqeverisje lokale, si një organ i vetëm, ka kryer aktivitete nga fushëveprimet e njësive të mëposhtme organizative:

Spektori për administratë dhe çështje normative

1.1 Zyra e burimeve njerëzore

1.2 Zyra e gjendjes civile

Spektori për punë dhe mirëqenie sociale

1.1 Zyra e menaxhimit të destinacionit për personat me nevoja të veçanta

Spektori për kulturë dhe sport

1.4 Zyra e Rinisë dhe për parandalimin e sëmundjeve të varësisë

Realizimi i funksionit të Sekretariatit për vetëqeverisjen lokale

Për fazën raportuese, Sekretariati ka organizuar:

Diskutime publike (Plani lokal i veprimit për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë për periudhën 2021-2023, Strategjia e punësimit e Komunës së Tuzit 2021-2025);

Takime të shumta me përfaqësues të OJQ-ve, SHKA-ve, si dhe me qytetarë të shumtë, puna e të cilëve kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e sportit dhe kulturës;

Sekretarja dhe punonjësit e Sekretariatit morën pjesë në trajnime të shumta, seminare, punëtori, konferenca si në ato kombëtare ashtu dhe në ato rajonale, si më poshtë:

1. Hartimi i Planit të kuadrove;
2. Veprimtaria e zyrës;
3. Ligji mbi procedurën administrative;
4. Analiza e nevojave për trajnim;
5. Vlerësimi i zyrtarëve dhe punonjësve lokalë;
6. Qasje e lirë në informacion;
7. Seminar me temë „Ndërgjegjësimi për fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në nivelin lokal”.

Sekretariati për vetëqeverisjen lokale ka organizuar aktivitetet në vijim:

- Manifestimi „Vera në Malësi” brenda të cilit u organizuan:
 - „Panairi i Librit”;
 - „Zbulimi i talenteve të reja”;
 - „Mbrëmje letrare”;
 - „Panairi i artizanateve”.
- „Dita Ndërkombëtare e Kancerit të Gjirit” - një leksion i mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Tuzit, në mbështetje të muajit të luftës kundër kancerit të gjirit;
- „Pazari dimëror në Malësi”.

Funksioni normativ i Sekretariatit për vetëqeverisje lokale

Në periudhën raportuese, u hartuan dhe miratuan aktet e mëposhtme:

- Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Sekretariatit për vetëqeverisje lokale;
- Vendimet për krijimin e 16 bashkësive lokale;
- Vendimi për krijimin e Këshillit rinor;
- Plani lokal i veprimit për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë për periudhën 2021-2023;
- Strategjia e punësimit e komunës së Tuzit 2021-2025.

Funksioni administrativ i Sekretariatit për vetëqeverisje lokale

Në përputhje me Vendimin për të drejtat nga Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve, në periudhën raportuese Sektori për punë dhe mirëqenie sociale ka marrë:

- 207 kërkesa për ndihmë financiare të njëhershme, nga të cilat 182 janë zgjidhur pozitivisht, dhe 24 janë në proces të zgjidhjes, ndërsa 1 është pezulluar.
- 200 kërkesa për ushtrimin e së drejtës për një paketë dhuratash për fëmijë të porsalindur.

Në pajtim me Rregulloren për librezën e punës, si dhe për librezën e vullnetarëve, Sekretariati për vetëqeverisje lokale, dmth, Sektori për punë dhe mirëqenie sociale pranoi:

- 239 kërkesa për hapjen e librezave të reja të punës, nga të cilat 1 u tërhoq nga kërkesa dhe 238 u zgjidhën pozitivisht;
- 67 kërkesa për regjistrim shtesë të të dhënave në librezën e punës, nga të cilat 1 u tërhoq nga kërkesa dhe 66 u zgjidhën pozitivisht;
- 7 kërkesa për të hapur librezë vullnetare, të gjitha u zgjidhën pozitivisht.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për turizmin dhe hotelerinë i cili përcakton detyrat dhe detyrimet e kryerjes së procedurave administrative për subjektet e biznesit, sipërmarrësit dhe personat fizikë të cilët merren me hotelieri dhe turizëm, gjatë periudhës raportuese, kanë dorëzuar gjithsej 47 kërkesa, nga të cilat 43 kanë të bëjnë me lëshimin e lejeve për hotelieri dhe 4 marrja me qira e automjeteve pa shoferë (renta car). Nga numri i deklaruar i kërkesave, 40 janë zgjidhur pozitivisht, 6 janë refuzuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative për shkak të mangësive formale dhe 1 kërkesë është në pritje.

Gjatë procedurës administrative për lëshimin e miratimeve për kryerjen e aktiviteteve hotelierike brenda kompetencave të këtij organi publik, punonjësit vizituan vendet për të përcaktuar përmbushjen e kushteve në pikëpamje të plotësimi të kushteve dhe objektit në përputhje me klauzolat e parashikuara nga rregullorja për llojet, kushtet minimale teknike dhe kategorizimin e objekteve hotelierike.

Kur bëhet fjalë për fushën e tregtisë e cila rregullohet me Ligjin për tregtinë e brendshme procedura administrative nuk zhvillohet në përputhje me aplikacionet e paraqitura, por ato përpunohen për regjistrimin e të dhënave në regjistrin e evidencave tregtare. Mbi atë bazë, në periudhën raportuese në lidhje me vitin 2020, dhe në përputhje me ndryshimet në Ligjin e përmendur, Drejtoria për çështje të inspektimit - Departamenti për inspektimin e tregut paraqiti 54 kërkesa në këtë organ publik, të cilat përfshijnë regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e aktiviteteve të tregtisë.

Gjithashtu, i njëjti numër i aplikacioneve në periudhën raportuese iu përcollën Administratës lokale të të ardhurave publike të Komunës së Tuzit për mbajtjen dhe regjistrimin në regjistrat e tyre.

Në fushën e zanateve, e cila është gjithashtu brenda kompetencës së këtij Sekretariati dhe rregullohet nga Ligji për mjeshtri dhe aktet nënligjore, 14 aplikime u paraqitën në periudhën raportuese, nga të cilat 13 i referoheshin fillimit të kryerjes së një aktiviteti artizanal dhe 1 ndryshimit të të dhënave nga aplikimi.

Gjithashtu, në përputhje me dispozitat e rregulloreve të mësipërme, i njëjti numër certifikatash janë lëshuar sipas detyrës zyrtare, të cilat janë skanuar dhe dorëzuar me e-mail në Dhomën e zëjtarëve të Malit të Zi.

Lidhur me oraret e zgjatura të punës së subjekteve ekonomike që operojnë dhe kryejnë veprimtari në territorin e komunës sonë në përputhje me dispozitat e Vendimit për orarin e punës, në afatin raportues u paraqit një kërkesë dhe i njëjti u ndërpre për shkak të pamundësisë për të vepruar sipas të njëjtës, për shkak të masave të Trupit koordinues nacional për sëmundjet infektive të Qeverisë së Malit të Zi (TKN) me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë së korona virusit.

Gjatë periudhës së hartimit të raportit, nuk është paraqit asnjë ankesë ndaj kompetencave ose punës së Sektorit për ekonomi, i cili përfshin sipërmarrjen, hotelerinë, turizmin, tregtinë dhe artizanatin.

Gjithashtu, në mënyrë që të zbatohen aktivitetet e parashikuara nga Plani lokal i veprimit për Rininë e komunës së Tuzit (2020 - 2021) i përgatitur nga Sekretariati për vetëqeverisje lokale të Komunës së Tuzit, më 25 Shkurt 2020, dhe i njëjti u miratua nga Kuvendi i komunës së Tuzit në vitin 2019. Në shkollën fillore „Mahmut Lekiq” në Tuz, u mbajt një ligjëratë për nxënësit dhe të rinjtë nga Komuna e Tuzit me temën e ndërmarrjes. Gjithashtu, në nëntor të vitit aktual, u realizua një aktivitet tjetër nga dokumenti i miratuar. Gjegjësisht, më 6 dhe 7 nëntor 2020 në Delta City në Podgoricë, Unioni i sipërmarrësve të rinj të Malit të Zi me partnerët e tij organizoi Panairin IV të Sipërmarrësve të rinj, në të cilin morën pjesë 30 sipërmarrës të rinj dhe katër organizata dhe institucione në fushën e sipërmarrja e të rinjve të cilët përfaqësuan bizneset e tyre në hollin e qendrës tregtare në fjalë.

Në këtë drejtim, ky organ juridiko publik organizoi në ditën e dytë të Panairit (7 nëntor) me të rinjtë nga Komuna e Tuzit një vizitë në organizimin e përmendur, ku vizitorët e rinj patën mundësinë të vizitojnë standat e Panairit dhe të njihen me shërbimet dhe produktet e sipërmarrësve të rinj në të gjithë Malin e Zi.

Gjatë periudhës raportuese, sektori i ekonomisë caktoi kapacitetet dhe punonjësit e tij dhe ndihmoi personat e papunë nga komuna jonë kur aplikuan për projektin e mbështetjes së vetë-punësimit të zbatuar nga Enti për punësim i Malit të Zi.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Zyra për burime njerëzore, pasi paraqiti vendimin për fillimin e procedurës për plotësimin e vendeve të lira të punës nga drejtuesit e organeve dhe shërbimeve të administratës lokale, ka publikuar: 20 njoftime publike, 2 konkurse publike dhe 7 njoftime të brendshme.

Gjatë kësaj periudhe janë shpallë 20 Shpallje publike, 2 Konkurse publike dhe 7 Shpallje interne.

Zyra për resurset njerëzore kryen punë të cilat kanë të bëjnë me propozimin e planit kadrovik për organet e administratës lokale, shërbimit profesional, gjegjësisht shërbimit të veçantë, e lidhur me këtë sipas aktit numër 04-032/20-1063 prej më 31.01.2020, Sekretariati për vetëqeverisje lokale i ka dorëzuar Shërbimit të kryetarit propozimin e Planit kadrovik të komunës së Tuzit për vitin 2020.

Në kompetencat e Zyrës për resurset njerëzore përket dhe analiza e nevojave për trajnim e cila ka për qëllim të përcaktoj nëse trajnimi është i nevojshëm e nëse po cili. Në bazë të analizës vihet deri te trajnimi adekuat, i cili do të mundësoi që të punësuarit të japin kontribut më të madh në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve zhvillimore në nivel të organeve. Lidhur me këtë zyra për resurset njerëzore në bazë të analizës ka përgatitur Planin vjetor trajnues për vitin 2021 dhe ia ka dorëzuar shërbimit të kryetarit.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit familjar si dhe Vendimit mbi organizimin e punëve të lidhjeve martesore në territorin e Komunës së Tuzit, Zyra për gjendjen civile ka kryer punët në vijim:

1. Vërtetime të dokumenteve, transkriptimet dhe vërtetësia e dorëshkrimeve dhe deklaratave për bashkësitë familjare - 24
2. Vërtetime të autorizimeve, pëlqime, deklaratat personale, deklarata për mbështetje, nënshkrimet të depozituara, letra garanci - 1,254
3. Dokumentacione mbi tenderët- 8.139
4. Kurorëzime në ambiente zyrtare- 76
5. Kurorëzime jashtë ambienteve zyrtare - 3
6. Certifikata nga RAK -186
7. Certifikata internacionale nga Regjistri Amëz i Kurorëzimeve (RAK) -63
8. Regjistrime kompozuese në RAK - 10
9. Certifikata mbi jetën -35.

Në përputhje me rregulloret e Ligjit për OJQ-të, si dhe Vendimin mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën për ndarjen e fondeve për Organizatat joqeveritare, dy organizata joqeveritare, „Fëmijët e Malit të Zi” dhe „Koret”, kanë fituar status të veçantë, të cilave u janë ndarë fonde për ndihmë pa shpallur konkurs publik.

Në pajtim me rregulloret e Vendimeve mbi bashkësitë lokale, janë formuar 16 bashkësi lokale si në vijim „Traboïn“; „Koja“; „Kshevë“; „Rakiq“; „Dheu i Zi“; „Drume“; „Dushiq – Lekaj“; „Dinoshë“; „Omerbozhaj“; „Narhelm-Dreshaj“; „Rranza e Sukes“; „Sukruq“; „Triesh“; „Vrane“; „Vllanë” dhe „Vuksanlekaj”.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për sportin dhe Vendimit për financimin e sportit, u shpall një tender publik për bashkëfinancimin e programeve të organizatave sportive dhe u miratua Vendimi për ndarjen e fondeve, si më poshtë:

Teakwondo klub „Besa”	Tuzi	8.500,00
Klubi futbollistik „Malësia 2010”	Tuzi	5.000,00
Teakwondo klub „Alba”	Tuzi	2.800,00
Klubi fudbollistik „Tuzi”	Tuzi	1.700,00
Totali		18.000,00

Bazuar në Vendimin për financimin e sporteve, Sekretariati për vetëqeverisje lokale pa shpalljen e konkurseve ka financuar programe që ishin të rëndësishme për përfaqësimin e suksesshëm të Komunës në skenën vendore dhe ndërkombëtare, gjë që përmirëson punën e organizatave sportive edhe në raste të tjera të jashtëzakonshme. Gjithashtu, për sportistët që ishin anëtarë të organizatës sportive në TK „BESA”, është ndarë një çmim për rezultatin e arritur sportiv në gara zyrtare.

Në përputhje me dispozitat e Vendimit për bursimin e studentëve në Komunën e Tuzit, Sekretariati për vetëqeverisje lokale ka shpallur konkurs publik për ndarjen e bursave për vitin 2020 . Bazuar në konkursin publik, kryetari i komunës lidhi marrëveshje për bursa me 7 (shtatë) studentë nga Komuna e Tuzit.

Kapaciteti organizativ dhe kadrovik për të kryer funksionin e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale

Në përputhje me Rregulloren e vlefshme për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Sekretariatit për vetëqeverisje lokale, në periudhën raportuese, përveç Sekretarit, u punësuan edhe 11 punonjës/e.

2. SEKRETARIATI PËR FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Gjatë vitit 2020, Sekretariati për financa dhe zhvillim ekonomik ka kryer detyra në lidhje me përgatitjen, planifikimin dhe hartimin e Buxhetit komunal, pastaj përgatitjen e raporteve për zbatimin e politikës fiskale për vitin aktual dhe propozimin e udhëzimeve në bazë të të cilave janë të hyrat dhe shpenzimet planifikuar për vitin aktual dhe vitin e ardhshëm.

Monitorimi i përdorimit të fondeve të aprovuara të njërive shpenzuese, paraqitja e raporteve për të ardhurat dhe shpenzimet në Ministrinë përkatëse të financave;

Kryerjen e analizës së rregulloreve që përcaktojnë të ardhurat publike lokale (taksa, tatimet, tarifa dhe kompensime) si dhe analizën e efekteve të zbatimit të këtyre rregulloreve në mënyrë që të realizohet politika e përshtatshme fiskale;

Është krijuar një sistem i veprimtarisë së thesarit, i cili mbështetet në standardet dhe rregullat ndërkombëtare të përshkruara nga Ministria e financave;

Në përputhje me Ligjin për financimin e vetëqeverisjes lokale, bën pagesa në bazë të dokumentacionit të duhur, mirëmban sistemin e kontabilitetit në sistemin e informacionit financiar të Thesarit të vetëqeverisjes lokale;

Janë krijuar procedura të brendshme që përcaktojnë qartë hapat dhe ndajnë përgjegjësitë në përputhje me Ligjin për buxhetin dhe përgjegjësinë fiskale;

Sekretariati për financa dhe zhvillim ekonomik, kryen detyra financiare dhe kontabël për; buxhetin, organet administrative, investimet kapitale dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të infrastrukturës publike. Sistemi i operacioneve të thesarit përfshin njësitë shpenzuese, pagat e punonjësve të cilat financohen nga buxheti komunal dhe kështu zgjerojnë aktivitetet e kontabilitetit në fushën e monitorimit dhe kryerjes së aktiviteteve të caktuara financiare dhe të kontabilitetit të njërive shpenzuese, dorëzimin e rregullt të raporteve në njësitë shpenzuese ,mbi evidencën në Thesar me qëllim të regjistrimit në ato njësi konsumatore.

Plani për avancimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në komunë është duke u përgatitur; Koordinimi i aktiviteteve për zhvillimin dhe zbatimin e menaxhimit dhe kontrollit; Ndiurma për menaxherin e njësisë ekonomike në zhvillimin dhe përcaktimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut;

Përgatitja dhe monitorimi i zbatimit të planit për eliminimin e mangësive në kontrollet e brendshme;

Përgatitja e një raporti vjetor për aktivitetet për zbatimin dhe përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit;

Raportimi i menaxherit të subjektit për situatën dhe zhvillimin, përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit dhe bashkëpunimin me Njësinë qendrore për harmonizimin e Ministrisë së financave;

Ka përfunduar përgatitja e vendimeve dhe akteve në bazë të të cilave përcaktohen të ardhurat lokale publike, e janë të krijuara parakushtet për transferimin e të ardhurave të caktuara komunale, pasi të jenë marrë kodet komunale dhe llogaria kryesore e thesarit dhe llogaritë në të cilat janë paguar të hyrat publike lokale Në pajtim me nenin 50, paragrafi 4 i Ligjit për administratën tatimore;

Bëhet evidentimi mbi fondet e tërhequra dhe të kthyera nga Fondi revolving për secilin projekt veç e veç në përputhje me rregulloren për mënyrën e tërheqjes dhe kthimit të fondit për përkrahjen e komunave për para financim të projekteve të donatorëve si dhe koordinimin e procesit të analizës së nevojave, efekteve financiare dhe hartimit të propozim projekteve për të konkuruar;

Janë sjellë udhëzimet e brendshme për llogaritjen dhe pagimin e pagave si dhe për pagesën e faturave hyrëse.

Është përfunduar raportimi financiar dhe monitorimi i performancës së projekteve;

Është kryer analiza e programit të mbështetjes së fondeve të BE-së në dispozicion të vetëqeverisjeve lokale brenda programit të Mbështetjes së ara-anëtarësimit (IPA) dhe është propozuar përzgjedhja e ekipeve të projektit për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve specifike;

Sekretari i Sekretariatit kreu punën e Koordinimit të grupit punues dhe këshillues të punës dhe mori pjesë aktivisht me bashkëpunëtorët e tij në zhvillimin e dokumentit më të rëndësishëm të zhvillimit të Komunës - Planit strategjik të zhvillimit të Tuzit 2021 - 2026, si dhe në zbatimin e dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore, ka dorëzuar të dhënat dhe propozimet e projekteve ndaj organeve shtetërore duke u përkujdesur për realizimin e tyre.

Jemi vlerësuar nga Ministri i financave si një nga komunat më të suksesshme që rregullon detyrimet e veta rregullisht, e cila nuk ka borxhe kredie ose garanci të lëshuara. U vlerësua pozitivisht për mbajtjen e librave të biznesit, për prezantimin e veprimtarisë së thesarit dhe formave dhe procedurave të brendshme që përshkruajnë veprimet financiare të vetëqeverisjeve lokale.

Aktivitetet u koordinuan në bashkëpunim me Ministrinë e ekonomisë, MONSTAT dhe organet e tjera kompetente shtetërore, në mënyrë që të përcaktohet niveli i zhvillimit të komunës së Tuzit, dhe kjo u realizua për herë të parë, kështu që Komuna e Tuzit është në listë të komunave në zhvillim në Mal të Zi, në grupin 3 të komunave më pak të zhvilluara bashkë me komunat e tjera me nivel të zhvillimit prej 56%, i cili na mundësoi stabilitet financiar, d.m.th., në periudhën e ardhshme katërvjeçare shumë prej 2 milion eurove në vit ose 8 milion euro për katër vitet e ardhshme sipas Ligjit për zhvillimin rajonal.

Opinion pozitiv i auditimit të pavarur u fitua në Llogarinë përfundimtare të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2019. Është nisur procedura për hartimin e projektbuxhetit dhe u zhvillua debati brendshëm publik me njësitë shpenzuese. Pastaj u organizua një debat publik, u mor një mendim pozitiv i Ministrisë së financave për propozimin e buxhetit, dhe propozimi i buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2021 u përcaktua në një shumë rekord me vlerë prej 5.8 milion euro.

Projekti PAST4Future - promovimi i turizmit të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm për të ardhmen u përfundua pas 2 vitesh dhe 9 muaj implementimi më 31.12.2020. Projekti u implementua në bashkëpunim me partnerin kryesor, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së Tiranës, Komunën e Malësi e Madhe, Komunën e Gravina të Italisë, Kooperativën ESCOOP të Italisë dhe Molise toward 2000 nga Italia. Shuma totale e buxhetit të Komunës së Tuzit ishte 162,167.50 euro, nga të cilat 85% ishin donacione të BE-së. Aktivitetet e fundit të projektit kishin të bënin me turneun edukativ dhe ngjarjet përfundimtare u organizuan në Dhjetor 2020 krahas respektimit maksimal të masave epidemiologjike.

3. ADMINISTRATA E TË ARDHURAVE LOKALE PUBLIKE

Aktivitetet lidhur me tatimet në patundshmëri për vitin 2020

Aktiviteti kryesor i Administratës së të ardhurave publike lokale të komunës së Tuzit ishte marrja e informacionit nga Administrata e pasurive të patundshme në lidhje me bazën e të dhënave për të gjitha pasuritë e patundshme në territorin e Komunës së Tuzit për individët dhe personat juridikë që nga 31.12.2019. Përfshirja (në bashkëpunim me kompaninë B-one) e të gjitha të dhënave të mësipërme të pasurive të patundshme për individët dhe personat juridikë në softuerin komunal, është azhurnuar baza e të dhënave për pasuritë e paluajtshme në territorin e Komunës së Tuzit, duke i mundësuar komunës që të lëshojë vendimet për tatimin në patundshmëri.

Është plotësuar baza e të dhënave të shoqërive të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Tuzit, dhe kjo përditësohet çdo ditë me shoqëri afariste të tjera të cilat nuk kanë qenë në regjistrin e administratës tatimore ose me shoqëri të reja. Bëhet fjalë për shoqëritë afariste të cilat, për herë të parë në llogarinë e komunës së Tuzit (në pajtim me Ligjin mbi financimin e vetëqeverisjes lokale) pas lajmërimeve dhe vërejtjeve nga ana e administratës së të ardhurave lokale publike, paguajnë tatimin në të ardhurat e personave fizik, tatimin në patundshmëri, kompensimet për rrugët komunale dhe të ardhura të tjera të cilat i parasheh Ligji.

Është formësuar çmimi mesatar për m² të truallit në territorin e Komunës së Tuzit- i është nisur shkresa Administratës tatimore të Malit të Zi – Kërkesë për dorëzimin e mostrave përfaqësuese (në bazë të kontratës mbi shitblerjen e truallit), që paraqet të dhëna shumë të rëndësishme për komunën.

Na bazë të të dhënave të MONSTAT-it, e në pajtim me çmimin mesatar për m² të objektit të ndërtuar në Mal të Zi, dhe në bazë të koeficientit nga vendimi mbi tatimin në patundshmëri të Komunës së Tuzit, janë përlllogaritur çmimet për m² për objektet e banimit, objektet afariste, prodhuese, ndihmëse, etj.

Është formuar baza e të dhënave për personat fizik të cilat e kanë vendbanimin në Komunën e Tuzit. Përmes nisjes së shkresave drejtë MPB-së të MZ me kërkesën për dorëzimin e të dhënave në formën elektronike (CD) mbi banorët të cilët e kanë të lajmëruar vendqëndrimin në territorin e Komunës së Tuzit. Kjo është bërë me qëllim të përcaktimit të taksës në patundshmëri për objektet primare dhe sekondare, gjejësisht përcaktimin e vendit kryesor të banimit të tatimpaguesit.

Pas ardhjes së bazës së lartpërmendur nga MPB-ka e MZ, në bashkëpunim me firmën B-One, janë inkorporuar të gjitha të dhënat (persona fizik të cilët kanë vendqëndrim në territorin e Komunës së Tuzit) në softuer, në mënyrë që të bëhet përcaktimi sa më preciz i obligimit tatimor për patundshmëri për personat fizik për vitin 2020.

Njëkohësisht, të gjitha shoqërive afariste të cilat posedojnë patundshmëri në territorin e Komunës së Tuzit, u është nisur ftesa për plotësimin dhe dorëzimin e paraqitjes së tatimit në patundshmëri në administratën e të ardhurave lokale publike të Komunës së Tuzit.

Në koordinim me Postën e Malit të Zi është përcaktuar mënyra dhe çmimi për shërbimet e dorëzimit të 7800 aktvendimeve për tatim në patundshmëri për personat fizik për vitin 2020. Pastaj, është bërë rrytëzimi i Postës së malit të Zi me firmën B-One, me qëllim të transferimit elektronik të bazës së të dhënave ma aktvendimet për tatim në patundshmëri për vitin 2020.

Administrata e të ardhurave lokale publike ka treguar për lëshimin e Administratës tatimore të Malit të Zi lidhur me shitjen e patundshmërive në territorin e Komunës së Tuzit. Kështu me vështrimin në aktvendimin nr.03/8-2-3979-3/19; aktvendimi numër 03/8-2-17532-3/17; aktvendimi numër 03/8-2-14790-3/18; aktvendimi numër 03/8-2-10587-3/19, të cilët kanë të bëjnë me marrëdhëniet në kontratat mbi shitblerjen e patundshmërive në territorin e Komunës së Tuzit, është ardhur deri te përfundimi se ka ekzistuar gabimi gjatë shfrytëzimit të shifrës së Komunës, gjegjësisht shfrytëzimit të shifrës së Kryequtetit-302, në vend të shifrës së Komunës së Tuzit-337, ndërsa kontratat janë atribuar shitblerjes së patundshmërive në territorin e Komunës së Tuzit. Pas intervenimit tonë mjetet janë drejtuar në llogarinë e Komunës së Tuzit. Bëhet fjalë për 42.000,00 eura.

Lënda lidhur me tatimin në patundshmëri për vitin 2020 e cila ka të bëjë me firmën „13 korriku Plantacionet” e kanë përcjellë shumë takime të rëndësishme, diskutime gojore, shkresa, negociata, lajmërimi mbi rezultatet e procedurës së bisedimeve që në fund Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit duke vepruar në pajtim me rregulloren mbi kriteret e hollësishme për përcaktimin e vlerës së tregut për patundshmëri ka sjellë aktvendimin me të cilin definohet detyrimi për këtë firmë që të paguaj vlerën prej 624.378,18 euro për tatim në patundshmëri për vitin 2020. tatimpaguesi ka paguar 100.000,00 euro pas disa ditëve, mirëpo nuk është paguar pjesa tjetër e shumës së përmendur. Pasi që aktvendimi është bërë o ekzekutueshëm, Administrata e të ardhurave lokale publike ka ngritur procedurën e pagesës së detyruar, dhe me sukses ka bërë pagesën e pjesës tjetër të borxhit. „13 korriku Plantacionet”, kanë dorëzuar ankesë në aktvendim, dhe kjo ankesë është refuzuar nga ana e Kryeadministratorit.

Konfigurimi i softuerit në bashkëpunim me B-One shpk - kompania që mirëmban softuerin tonë

Në softuerin e administratës është futur forma e Vendimit dhe arsyetimet e aktvendimeve për aktvendimet për tatime në patundshmëri për personat fizik në të dyja gjuhët për vitin 2020. Në atë mënyrë Komuna e Tuzit, për herë të parë, ka dërguar 7800 aktvendime për tatimet në patundshmëri për personat fizik të cilët kanë patundshmëri në territorin e Komunës së Tuzit.

Në softuer është edhe forma e Vendimit dhe arsyetimit për aktvendimin për kompensimin për shfrytëzimin e objekteve komerciale të cilave u është mundësuar qasja nga rrugët komunale dhe atyre të pa kategorizuara për vitin 2020. Gjithashtu në softuer është edhe Vendimi i arsyetimit të aktvendimit për tatim në patundshmëri për personat fizik e vitit 2020 dhe janë lëshuar 42 aktvendime për tatim në patundshmëri për personat fizik për vitin 2020.

Në softuer është edhe formë e Vendimit dhe arsyetimit për aktvendimin për kontributin e anëtarësisë ndaj organizatës turistike për vitin 2020, si dhe forma e vendimit dhe arsyetimit për taksat lokale komunale për vitin 2020.

Në bashkëpunim me firmën B-One, secila KK e Komunës së Tuzit është veçanërisht e rregulluar në zonën I dhe zonën II, me qëllim të përcaktimit të drejtë të bazës për taksën në patundshmëri për personat fizik për vitin 2020.

Aktivitetet lidhur me kompensimin për rrugët komunale për vitin 2020

Kur flasim për aktivitetet për kompensimin lidhur me rrugët komunale janë çuar vërejtjet në pagesën e detyrueshme të gjitha shoqërive afariste të cilat nuk e kanë kryer detyrimin për kompensimin për rrugët komunale për vitin 2019. Pas afatit të rregulluar me ligj është proceduar me pagesën e detyrueshme në komunikim me Bankën qendrore të Malit të Zi në ekzekutim, ku pas kësaj ka pasuar

bllokimi i xhiro llogarive i atyre shoqërive afariste dhe pagesa e detyrimeve në favor të Komunës së Tuzit.

Janë sjellë dhe dorëzuar 208 aktvendime për kompensimin për shfrytëzimin e objekteve komerciale të cilave u është mundësuar qasja nga rrugët komunale.

Duke marrë parasysh situatën pandemike, komuna ka miratuar zbritje prej 4 muajsh (33%) për këtë lloj kompensimi për shoqëritë afariste të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Tuzit, prandaj shumata totale e pa paguar për këtë kompensim për vitin 2020 ka qenë 41.215,00 euro.

Është formuar komisioni dhe janë udhëhequr procedurat juridike për përcaktimin e gjatësisë së kablllove, tubave të ujësjellësit instalimeve elektrike dhe ujësjellësve të tjerë në rrugët e territorit të Komunës së Tuzit. Pas diskutimeve shumë mujore, shkresave, takimeve, për herë të parë është bërë përcaktimi i kompensimit vjetor për tubat e ujësjellësit, ujësjellësin, kanalizimin, elektrifikimin, linjën telefonike, telegrafike dhe ngjashëm, në rrugët komunale për vitin 2020, për shoqëritë afariste „Telekom”, CEDIS „Ujësjellësi dhe kanalizimet” dhe „Shërbimet komunale” dhe aktvendimi për M-tel. Kompensimet e cekura, në nivel vjetor janë mbi 90.000,00 euro.

Plotësimi i bazës së të dhënave në bazë të aktvendimeve të reja për punë të lëshuara nga ana e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale të komunës së Tuzit

Janë sjellë mbi 200 aktvendime mbi shfrytëzimin e rrugëve komunale, duke u bazuar në bazën e shoqërive afariste të cilat kanë plane për objekte në territorin e komunës së Tuzit. Këtë bazë e kemi fituar duke plotësuar bazën ekzistuese me paraqitjet e tregtisë, e cila i është dorëzuar administratës nga ana e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale të Komunës së Tuzit.

Në mënyrë që të sjellim aktvendimet edhe për disa veprimtari të tjera të cilat nuk i kemi gjetur në Sekretariatit për zhvillim e afarizmit, na është dashur të komunikojmë edhe me disa institucione të tjera shtetërore në varësi prej llojit të veprimtarisë së përcaktuar të shoqërive afariste.

Kështu komunikimi është bërë me:

- Ministrin e komunikacionit,
- Ministrinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit,
- Administrata për Komunikacion,
- Agresionit për energjetik,
- Administratën për lojërat e fatit.

Aktivitet lidhur me kontributin e anëtarësisë ndaj Organizatës turistike të Tuzit

Përfaqësuesit e administratës kontaktuan kompanitë që nuk paguanin kontributin në 2019. Për shkak të situatës me COVID-19, Komuna e Tuzit i ka lëshuar përkohësisht pagesën e detyrimit për kontributin e anëtarësisë të TO për 2020.

Aktivitetet e lidhura me mbitatimin në tatim në të ardhurat e personave fizik

Është kryer komunikimi/raportimi i rregullt përmes telefonit email-ve komunikimi zyrtar përmes shkresave me shoqëritë afariste të cilat kanë punëtorë të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Tuzit.

Është bërë evidentimi i shoqërive afariste të cilat janë në detyrim të pagesës së mbitatimit, e nuk e kanë paguar. Është kryer komunikimi, thirrjet përmes telefonit email-ave dhe përmes agjencive llogaritare të cilat i kryejnë shërbimet e udhëheqjes së regjistrave të shoqërive afariste nga Tuzi. E gjitha kjo me qëllim të njoftimit të shoqërive afaristeme detyrimet që kanë në llogari të Komunës së Tuzit.

Në bazë të këtij lloj komunikimi kemi arritur që ta rrisim numrin e shoqërive afariste të cilat bëjnë pagesën e mbitatimit në llogari të Komunës së Tuzit në 264 të tilla, gjë e cila paraqet rritje në krahasim me vitin 2019. Në fillim të punës së administratës së të ardhurave lokale publike, në qershor të vitin 2019 pagesën e bënin 20 firma, ndërsa në fund të vitit 2019 numri i atyre firmave ka qenë 154.

Prej formimit të administratës numri i firmave të cilat paguajnë mbitatitimin, si dhe totali i mbitatimeve në tatim nga muaji në muaj rritet.

Ankesat në aktvendime për tatimet në patundshmëri për personat fizik për vitin 2020

Në 7800 aktvendime të tatimit në patundshmëri për personat fizik për vitin 2020, administrata ka fituar totalit 7 ankesa përmes avokatit. Janë mbajtur diskutime gojore me avokaten dhe është përfunduar procedura e rivlerësimit të tatimit në patundshmëri për vitin 2020. Për shpenzimet e procedurave për vitin 2020 janë paguar 2.178 euro. Kanë qenë 6 ankesa pa angazhim të avokatit, pra palëve u është mundësuar të marrin pjesë në procedurën e përcaktimit të taksës në patundshmëri dhe janë sjellë aktvendime të reja, pra për këto ankesa nuk ka pasur shpenzime shtesë.

Anulimi i numrit të caktuar të aktvendimeve për kontributin e anëtarësisë ndaj Organizatës turistike të Kryeqytetit si rezultat i komunikimit me Administratën e të ardhurave publike të Kryeqytetit

Shumica e aktvendimeve janë anuluar në vitin 2019, megjithatë, kanë qenë disa aktvendime edhe për vitin 2020 lidhur me kontributin e anëtarësisë ndaj organizatës turistike të cilat janë dorëzuar shoqërive afariste të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Tuzit nga ana e administratës së të ardhurave të Kryeqytetit. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të dorëzimit të gabuar të bilancit të suksesit të Administratës së të ardhurave të Kryeqytetit nga ana e shoqërive afariste të cilat veprojnë në Tuz. Pasi kjo është konstatuar, me dakordim mes dy administratave në mënyrë efikase janë anuluar aktvendimet e cekura. Përveç kësaj me Administratën e të ardhurave të Kryeqytetit, është arritur marrëveshja që shoqërive afariste që kanë paguar tu rikthehen mjetet në mënyrë që ato të paguajnë të Administrata e të ardhurave të Komunës së Tuzit. Në këtë proces rrol kyç kanë luajtur edhe të punësuarit e Administratës së të ardhurave lokale publike të Komunës së Tuzit.

Ri regjistrimi i firmave të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Tuzit, e në RQSA janë regjistruar si „Shpk Podgoricë”

Janë dërguar shkresat me informacionet e nevojshme për ri regjistrimin e të gjitha subjekteve ose shoqërive afariste selia e të cilave është në territorin e Komunës së Tuzit, e të cilat janë në Regjistrin qendror të subjekteve afariste të regjistruara si të ishin me vendqëndrim në Podgoricë (Tuzi p.n., vendi Podgorica) pas pranimit të lajmërimit për ri regjistrim në territorin e Komunës së Tuzit, një numër i caktuar i firmave e ka bërë ri regjistrimin në RQSA. Ky proces është duke vazhduar dhe duke u ndjekur edhe në vitin 2021.

Regjistrimi i certifikatave bankare dhe paraqitja në softuerin e Administratës së të ardhurave lokale publike

Certifikatat bankare për:

- Mbitatim në tatim në të ardhurat e personave fizik
- Tatimi në patundshmëri për personat juridik
- Tatimi në patundshmëri për personat fizik
- Kompensimi për shfrytëzimin e rrugëve komunale
- Kompensimet vjetore për tubacionet, ujësjellësit, kanalizimet, linja elektrike, telefonike dhe telegrafike dhe ngjashëm në rrugët komunale

- Pajisjet komunale të truallit ndërtimor
- Pajisjet komunale të truallit ndërtimor për objektet e paligjshme
- Kontributet e anëtarësisë ndaj Organizatës turistike

Çdo ditë është bërë regjistrimi i certifikatave dhe paraqitjeve të cilat arrijnë në Administratë të cilët paraqesin lëndë me rëndësi i cili kontribuon në efikasitetin në punë ç 'gjë administratën e bën organ i cili anon të përditësohet me të dhënat e pagesave, përgjegjës ndaj komunës sonë, por edhe ndaj shoqërive afariste të cilat prej administratës kërkojnë dhe tatime të ndryshme mbi gjendjen e detyrimeve të veta ndaj komunës.

Jo radhë, persona fizik dhe juridik pra palë të ndryshme administratën e kanë vlerësuar si tejet profesionale.

Krahas regjistrimit në softver, pagesat gjithashtu i evidentojmë në exel tabela në mënyrë që të kontrollojmë dyfish punën e administratës dhe të punësuarve në administratë.

Libri i brendshëm i (arkivit) për evidentimin e shkresave/paraqitjeve të pranuarra, dhe dorëzimin e të gjitha shkresave/aktvendime të Administratës së të ardhurave lokale publike

Libri i brendshëm përfaqëson element kryesor në procedurat e brendshme të administratës e cila qartë definojnë pranimin e akteve të administratës me informata të detajuara mbi pranimin e kërkesave, të punësuarve të cilët i marrin kërkesat për ti zgjidhur, në këtë mënyrë përcjellët kërkesa nga pranimi deri në zgjidhjen e saj dhe përcaktohet përgjegjësia brenda organit.

Në bazë të punës dhe angazhimi të Administratës së të ardhurave publike, janë sjellë 208 aktvendime për shfrytëzimin e objekteve komerciale të cilëve u është mundësuar qasja nga rrugët komunale, 42 aktvendime për tatim në patundshmëri të personave juridik, 7800 aktvendime për tatim në patundshmëri për personat fizik. Deri në fund të vitit mbi 260 firma paguajnë mbitatim në llogari të komunës së Tuzit e që flet për suksesshmerinë e funksionimit të organit. Gjithashtu mbi 350 firma paguajnë llogarinë e Komunës së Tuzit tatimin në patundshmëri, mbi tatimin në tatim, kompensimet për rrugën komunale, kompensimet vjetore për vendosjen e tubacioneve linjave, kabllove, kontributeve të anëtarësisë ndaj OTT, etj.

Të ardhurat mujore në llogarinë e Komunës së Tuzit në vitin 2020 janë paraqitur në tabelë:

Janar		114,688.64
Shkurt		59,307.50
Mars		223,134.58
Prill		767,298.92
Maj		126,373.27
Qershor		558,044.47
Korrik		83,429.78
Gusht		65,190.97
Shtator		73,865.49
Tetor		610,780.65
Nëntor		157,886.56
Dhjetor		636,938.11
TOTALI		3,476,938.94

Mjetet e bartura nga viti 2019 kanë qenë 461.656,81 EUR.

4. SEKRETARIJATI PËR PLANIFIKIM, RREGULLIM HAPËSINOR DHE PUNË KOMUNALE

Kompetenca e Sekretariatit të përmendur për vitin 2020 është përcaktuar sipas Vendimit mbi organizmin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit dhe me të njëjtin Vendim për vitin 2020 është caktuar organizimi i administratës lokale në Komunën e Tuzit, janë themeluar organet e administratës lokale, janë themeluar shërbimet e veçanta dhe profesionale, është përcaktuar fushëveprimi i tyre, mënyra e punës dhe çështje të tjera me rendësi për punën e tyre, gjithashtu ky Sekretariat ka kryer punë i pavarur në kuadër të autorizimeve të parapara me ligj, Statut të komunës me Vendimin e përmendur, me vendimet e Kuvendit dhe Rregullore të tjera. Sekretariati është marrë me rregullimin hapësinor, gjegjësisht ka përgatitur kushtet për shfrytëzimin e hapësirës krahas zbatimit të dokumenteve planore, derisa në kompetencat e veta i kanë rënë dhe punë komunale dhe të komunikacionit.

Me 16.12.2020, kryetari i Komunës së Tuzit ka sjellë Vendimin mbi organizimin dhe mënyrë e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit i cili zbatohet prej datës 01.01.2021 kur dhe ka pushuar së vlejuri Vendimi i vjetër.

Realizimi i funksioneve të organeve të Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale

Ky Sekretariat në fazën raportuese ka organizuar: pesë diskutime publike dhe për të njëjtat ky organ ka përpiluar raporte mbi realizimin e diskutime publike.

Punët normativo-juridike të Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale

Në periudhën raportuese ky Sekretariat ka përgatitur propozimin e programit të objekteve afariste dhe propozimet e akteve në vijim të cilat janë miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit:

- Vendimi mbi sjelljen e Programit të objekteve afariste për territorin e Komunës së Tuzit për periudhën 2020-2025;
- Vendimi për vendosjen, gjegjësisht ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e Komunës së Tuzit;
- Vendimi mbi përcaktimin e përkohshëm të emrave të vendbanimeve, rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Tuzit;
- Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm;
- Vendimi mbi vendosjen gjegjësisht ndërtimin dhe largimin e objekteve ndihmëse;
- Vendim mbi kompensimin për pajisjen komunale të truallit ndërtimor;
- Vendim mbi sanimin urban;
- Raport mbi gjendjen e rregullimit hapësinor të Komunës së Tuzit për vitin 2020;
- Programi i rregullimit hapësinor i komunës së Tuzit për vitin 2021.

Funksioni i administratës së Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale

Në këtë Sekretariat është themeluar organizimi i brendshme i njërive sektori për planifikim hapësinor, rregullim hapësinor dhe punë komunale i cili ka kryer çështje të administratës sipas nenit 9 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit.

Ky Sekretariat në Raportin punës për vitin 2020 lëndët i ka renditur në 3 fusha siç vijon:

➤ Planifikimi edhe rregullimi hapësinor

Me Ligjin mbi planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve i cili ka filluar që të zbatohet më 14. tetor 2017, janë krijuar kushtet ligjore për zbatimin e procedurës së legalizimit të objekteve të paligjshme. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit mbi planifikim hapësinor dhe ndërtimin e objekteve ka hyrë në fuqi më 14. gusht 2020, ku me ndryshimet e dhëna qytetarëve u është mundur dorëzimi i kërkesave për legalizim pa afat të caktuar krahas dorëzimit të dokumentacionit të paraparit me nenin 156 të Ligjit.

Në periudhën raportuese janë dorëzuar:

- **34** – kërkesat për legalizim të ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, të cilat janë dorëzuar në periudhën prej 01.01.2020. deri më 14.08.2020, d.m.th. pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave për legalizim dhe numër i njëjtë aktvendimesh për refuzimin e kërkesave për legalizim (kërkesa lidhur me afatin, nuk janë paraqitur brenda afatit)
- **32** – kërkesat për legalizim të ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme të paraqitura në periudhën prej 14.08.2020 deri më 31.12.2020, me dokumentacion të paplotë dhe për to janë çuar njoftime për plotësimin e dokumentacionit.
- **68** – kërkesat për lëshimin e certifikatave dhe numër i njëjtë i certifikatave të lëshuara (një numër më i madh i certifikatave ka të bëjë me kërkesat për legalizim, pastaj certifikatat që kanë të bëjnë me truallin, posaçërisht se për cilin qëllim është i paraparë trualli në parcelën kadastrale).

Lidhur me legalizimin e objekteve të paligjshme ky organ në periudhën raportuese ka lëshuar:

- **23** -aktvendime për përfundimin e procedurës për legalizim për shkak të faktit se objekti nuk ishte ndërtuar në përputhje me parametrat themelorë urbanistik të dokumentit të vlefshëm të planifikimit;
- **2** - vendime për legalizimin e objekteve;
- **109** - vërtetime (vërtetim i marrjes së dokumentacionit për legalizim)
- **1** - kërkesë për shndërrim nga banesa në lokal afarist u paraqit në 2019 dhe e njëjta u transferua dhe u zgjidh në vitin 2020 në përputhje me nenet e përshkruara të Rregullores për mënyrën e shndërrimit të një pjese të veçantë dhe të përbashkët të një ndërtese banimi në një lokal afarist ose ambient biznesi në një pjesë të veçantë ose të përbashkët të një ndërtese banimi.
- **9** - kërkesa për lëshimin e lejes për ndërtimin e një objekti lokal me interes të përgjithshëm në bazë të Vendimit për ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm në lidhje me nenin 223 paragrafi 2 i Ligjit për planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve.
- **8** - kërkesa u zgjidhën pozitivisht
- **1** - kërkesë është e pazgjidhur
- **1** - Kërkesë u paraqit për përcaktimin e kompensimit për pajisjet komunale të tokës ndërtimore dhe tarifa u përcaktua nga ky Sekretariat në përputhje me Vendimin mbi kompensimin për pajisjet komunale të truallit ndërtimor.

- **2** - kërkesa janë dorëzuar me qëllim të lëshimit të mendimit, pëlqimit ose dëshmie tjetër në procesin e revizionit të dokumentacionit teknik në përputhje me nenin 82 të Ligjit për planifikimin dhe ndërtimin hapësinor (kërkesa i referohet llogaritjes së shërbimeve për objektet e interesit të përgjithshëm) dhe për të njëjtat nga ana e këtij organi janë dhënë mendime, gjegjësisht, janë liruar nga pagesa e shërbimeve për komunalet.
- **1** - kërkesë u paraqit për lëshimin e një certifikate nga dokumenti planor dhe u zgjidh pozitivisht.
- **4** - kërkesa iu përcollën Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural të Komunës së Tuzit, duke marrë parasysh që kërkesat u paraqitën për të vendosur mbi nevojën e përgatitjes së një Studimi mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe palët u njoftuan për këtë gjë.
- **2** - kërkesa u refuzuan për shkak se nuk ishim kompetent (ky organ nuk mund të përcaktojë se cili organ është kompetent.
- **34** – Kërkesa janë paraqitur në vitin 2020 dhe ato nuk janë zgjidhur (kërkesa për instalimin e ngadalësuesve të shpejtësisë, kërkesa për asfaltim dhe rehabilitim të rrugëve në vendbanimet në territorin e Komunës së Tuzit).

Në përputhje me dispozitat e nenit 74 të të njëjtit Ligj, gjatë periudhës raportuese, ky organ publik ka marrë:

- **10** - kërkesa për lëshimin e kushteve tekniko-urbane:
- **8** - kërkesa u zgjidhen pozitivisht
- **2** - kërkesa nuk janë zgjidhur

Lidhur me këto, ky organ sipas kompetencave që ka, ka nisur:

- **8** – kërkesa sh.p.k „Ujësjellësit dhe kanalizimeve” për lëshimin e kushteve nga kompetencat e tyre.
- **8** – kërkesa për Administratën e Patundshmërive të PJ Podgorica për lëshimin e dëshmisë së pronësisë
- **6** - kërkesa për Administratën e Patundshmërive - PJ Podgorica për lëshimin e një kopje të planit
- **2** - kërkesa për Administratën e Patundshmërive - PJ Podgorica për lëshimin e një kopje të planit me koordinatat e parcelës.

Në përputhje me Vendimin për ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm në periudhën raportuese, u paraqitën kërkesat për aprovim, përkatësisht Vendime për përcaktimin e vendndodhjes me elementet e kushteve urbane dhe teknike për ndërtimin e objektit lokal me interes të përgjithshëm

- **13** – kërkesa për kushtet e KUT - vendimit për përcaktimin e vendndodhjes me elementet e kushteve urbanistike-teknike për ndërtimin e një objekti lokal me interes të përgjithshëm
- **13** – kërkesa të zgjidhura pozitivisht

Specifikimi i materialeve të kërkuara për përgatitjen e tenderit

- **30** - Numri total i specifikimeve të bëra

Detyrat projektuese

- **4** - Detyra projektesh të lëshuara nga ky Sekretariat
- **22** - Numri i punëve të përfunduara

- Procesverbalet mbi pranimin cilësor dhe sasior të punimeve
- **22** - Numri i përgjithshëm i pranimeve të procesverbaleve

➤ **Punët komunale**

Ky Sekretariat ka kryer mbikëqyrje administrative mbi punën e SHPK „Komunalno / Komunale” Tuz në përputhje me dispozitat e Nenit 9 paragrafit 1 pikës 33 të Vendimit mbi organizimin dhe funksionimin e administratës lokale të komunës së Tuzit i cili përcakton se Sekretariati për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale kryen detyra administrative në lidhje me mbikëqyrjen administrative, duke ushtruar të drejtat e themeluesve në shërbimet publike që kryejnë veprimtari dhe mbikëqyrje komunale, në zbatimin e planeve të mbrojtjes dhe shpëtimit; zgjidhja e ankesave kundër akteve të shkallës së parë të shërbimeve publike mbi të cilat bën mbikëqyrjen; dhënia e mendimeve për statutin, programin e punës, aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm, raportet e punës dhe propozimin e masave në lidhje me informacionin dhe materialet e tjera të këtyre shërbimeve për fushat brenda kompetencës së organit;

Në afatin raportues kemi pranuar:

- **1** – ankesë kundër SHPK „Komunalno / Komunale” Tuzi, e cila u miratua dhe u kthye për rigjykim dhe vendimmarrje.
- **2** - kërkesa janë dorëzuar nga Agjencia për mbrojtjen e mjedisit me qëllim të lëshimit të një mendimi nga ky organ për Planin e menaxhimit të mbetjeve për kompanitë e vendosura në komunën e Tuzit, dhe të njëjtat janë lëshuar nga ky organ brenda periudhës së parashikuar.

Programi objekteve të përkohshme për territorin e Komunës së Tuzit për periudhën 2020 - 2025

Kuvendi i Komunës së Tuzit në seancën e mbajtur më 9 qershor 2020 miratoi Vendimin për sjelljen e Programit të objekteve të përkohshme për territorin e komunës së Tuzit për periudhën 2020-2025.

Në lidhje me sa u tha më lart në periudhën raportuese u dorëzuan, gjithsej:

- **57** - kërkesa për lëshimin e miratimeve për instalimin, d.m.th. ndërtimin e objekteve të përkohshme me karakter montues
- **24** - kërkesa janë zgjidhur
- **33** - kërkesa nuk janë zgjidhur. Për të krijuar kushtet për zgjidhjen e tyre, është e nevojshme të ndryshohet Programi i përmendur.

➤ **Komunikacioni**

Në zbatim të urdhërësës për shënimin e hapësirave të parkimit për automjetet e personave me aftësi të kufizuara dhe paraqitjen e shenjave të aksesit që shënojnë automjetet e personave me aftësi të kufizuara dhe Vendimit për parkingjet publike të komunës së Tuzit në periudhën raportuese, u paraqitën kërkesa për lëshimin e shenjave qasëse të cilat shënojnë automjetin e një personi me aftësi të kufizuara.

- **12** – Numri i përgjithshëm i kërkesave për lëshimin e shenjave qasëse dhe i njëjti numër i tyre është zgjidhur.

Në pajtim me rregulloren e nenit 122 të Ligjit mbi transportin në komunikacionin rrugor, gjatë periudhës raportuese janë dorëzuar kërkesa në të cilat është kërkuar lëshimi i miratimeve për kryerjen e transportit për nevoja personale.

- 4 - Numri i përgjithshëm i kërkesave dhe i njëjti numër i çështjeve të zgjidhura pozitivisht.

Në zbatim të Vendimit mbi rrugët lokale dhe të pa kategorizuara, gjithsej janë dorëzuar:

- 3 - kërkesa për devijim dhe pezullim të trafikut dhe i njëjti numër i kërkesave është zgjidhur.
- 2 - kërkesa për gërmimin e truallit publike dhe sipërfaqeve të rrugës dhe numër i njëjti i çështjeve të zgjidhura pozitivisht.

Kapaciteti organizativ dhe i personelit për të kryer funksionin e Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe çështje komunale

Në përputhje me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe çështje komunale, në periudhën raportuese, përveç Ushtresit të detyrës së Sekretarit, u punësuan edhe dy nëpunës.

5. SEKRETARIATI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Sipas Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit është formuar Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural, ku me këtë Vendim janë definuar kompetencat e këtij sekretariat mjaft me rendësi duke marrë parasysh se bujqësia është njëra nga veprimtaritë jetike të qytetarëve të Komunës së Tuzit.

Rregullorja mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural si një organ i vetëm, përcakton njësitë organizative vijuese: Shërbimi për punët administrative dhe të tjera, Sektori për bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për ekologji dhe mbrojtje të mjedisit dhe Zyra për menaxhimin të zonave të mbrojtura në zonën e Monumentit natyror „Kanjoni i Cemit”.

Përveç ushtresit të detyrës së Sekretarit, është caktuar edhe një ushtres detyre i ndihmës-Sekretarit, si dhe pesë zyrtarë: Këshilltar i pavarur për çështjet ligjore dhe rregullore, Këshilltar i lartë III për mbrojtjen e bimëve, Këshilltar i lartë III për çështjet ekonomike dhe të kontabilitetit, Referent për ujëra, fusha e bujqësisë dhe pylltarisë si dhe Referent i pavarur për çështje teknike dhe administrative.

Funksioni normativ i Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural

Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural përpunoi dhe i dërgoi Kuvendit të Komunës dy vendime të cilat i miratoi më 5 nëntor 2019, si më poshtë:

- Vendim mbi qasjen në hartimin e Planit lokal të mbrojtjes së mjedisit në Komunë të Tuzit 2020 – 2024;
- Vendim mbi qasjen në hartimin e planit menaxhues të Monumentit natyror „Kanjoni i Cemit” për periudhën 2020-2025 ;
- Vendim për kushtet, mënyrën dhe dinamikën e shpërndarjes së fondeve të Buxhetit të Komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuara për bujqësi.

Punët dhe detyrat përfundimi i të cilave është në proces:

Vendimi për nxitje dhe investim në zhvillimin e bujqësisë, i cili i është dërguar ministrisë kompetente për marrjen e një mendimi, është në fazën e hartimit.

Në përputhje me detyrimin ligjor për zhvillimin e Hartës strategjike të zhurmës të Komunës së Tuzit, ka filluar përpilimi i një Hartës strategjike të zhurmës të Komunës së Tuzit.

Harta Strategjike e Zhurmës është e përgatitur në përgjithësi dhe përmban të dhëna për zhurmën e lëshuar nga rruga, hekurudha dhe transporti ajror dhe impiantet industriale për të cilat lëshohet një leje e integruar dhe çështje të tjera me rëndësi për mbrojtjen e zhurmës. Gjithashtu është iniciuan hartimi i Kadastrit të ndotësve të Komunës së Tuzit, aktualisht Komuna e Tuzit nuk posedon të dhënat të detajuara lidhur me Kadastrën e ndotësve, lokacionet dhe koordinatat e lëshimeve, llojet e veprimtarisë, gjegjësisht aktivitetet e ndotësve, materialet dhe mbetjet ndotëse, segmentet e ambientit jetësor në të cilat bëhet lëshimi i materialeve ndotëse ose ujërave ndotëse, përcjelljen e mbetjeve jashtë lokacionit dhe destinacionit të fundit të kalimit vetëm është dhënë iniciativa që e njëjta të hartohet.

Mbrojtja primare shëndetësore: Shtëpisë së shëndetit në Tuz i është drejtuar shkresa në të cilën kërkohen të dhënat për mbrojtjen primare shëndetësore të Komunës së Tuzit, në të cilin nuk ka pasur përgjigje.

Gjoja dhe peshkimi: Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural të Malit të Zi i është drejtuar një shkresë ku i është paraqitur Iniciativa për lokalizimin e vendit për gjueti të Gjuetia „Malësia, në të cilën kanë përgjigjur se pas ndarjes territoriale me Podgoricën do ti qasen hartimit të elaboratit i cili do të sjellët deri në pëlqimin e kushteve për lokalizimin e vendit të gjuetisë si një tersi në territorin e Komunës së Tuzit. Është përgatitur Projektvendimi mbi çmimet për gjuetinë e egërsirave të lejueshme në territorin e Komunës së Tuzit.

Për kanjonin e „Lumit Cem”, është drejtuar shkresa kryetarit të Komunës së Tuzit mbi nevojën emërimit të udhëheqësit të zyrës i cili do të merrej me këto çështje përmes informacioneve të detajuara mbi themelimin e zyrës, referencat e menaxhuesit dhe përgjegjësitë të cilat do ti tërhiqte formimi i kësaj zyre.

Jemi qasur sjelljes së aktvendimit mbi emërimin e grupit punues mbi hartimin e planit menaxhues të monumentit të natyrës „Kanjoni i Cemit” për periudhën 2020-2025, gjithashtu jemi qasur sjelljes së aktvendimit mbi emërimin e grupit punues për hartimin e Planit lokal për mbrojtjen e ambientit jetësor të Komunës së Tuzit për periudhën 202-2024.

Është përgatitur edhe programi i punës i këtij Sekretariati i cili i drejtohet Kuvendit të Komunës me qëllim të përfshirjes së tij në programin e punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit.

Kërkesa për dhënien e mendimit mbi qasjen në rastin e Vendimit të sjellë më parë për shpalljen e „Kanjonit të Cemit” Monument natyror i është drejtuar ministrisë kompetente në mënyrë që të sjellët një vendim i përshtatshëm dhe juridikisht i pranueshëm.

Është bërë përgatitja e moratoriumit mbi ndalimin e shfrytëzimit të përcmimeve ujore në lumin Cem pra të mirës natyre të mbrojtur „Kanjoni i Cemit” i përçar në vendimmarrje të mëtejshme pranë kryetarit të Komunës me qëllim të zbatimit të procedurave të mëtejshme.

Përfaqësuesit e Sekretariatit dy herësh kanë vizituar punimet në drejtimin Cem i Trieshit Dinoshë, i cili në gjithë gjatësinë e tij kalon përmes territorit të mbrojtur të monumentit natyror „Kanjoni i Cemit” për të cilin është përpiluar raporti mbi gjendjen në teren dhe i njëjti i është përçar kryetarit të Komunës. Raporti duhet të shërbejë për definimin e hapave të cilët vetëqeverisja lokale duhet të ndërmarrje në lidhje me mbrojtjen e përshtatshme të kësaj të mire natyrore.

Punët administrative nga fushëveprimi i Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural

Është themeluar Komisioni për vlerësimin e dëmeve, komisioni ka dalë në teren sipas kërkesave, 53 herë ku është bërë vlerësimi i dëmit me qëllim të ndihmës në sanimin e pasojave. Janë hartuar edhe procesverbalet mbi dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të cilat janë drejtuar organit kompetent. Struktura e kërkesës sipas natyrës së dëmeve është: 23 kërkesa për vlerësimin e dëmit të shkaktuara nga studia e erës, 12 kërkesa të cilat kanë të bëjnë me zjarret dhe 1 kërkesë që ka të bëjë me përmytjet si dhe 17 kërkesa të cilat kanë të bëjnë me fatkeqësi të tjera. Raportet me vlerësimet e dëmeve janë dorëzuar organit kompetent për kompensimin e tyre.

Me kërkesë të palëve janë lëshuar 35 vërtetime që parashtruesi i kërkesës është prodhues bujqësor prej të cilëve 20 me qëllim të rregullimit të kompensimit të moshës, q me qëllim të rregullimit të vizës udhëtuese, 2 me qëllim të shitjes në tregje dhe pjaca, 2 me qëllim të rregullimit të shtetësisë, 4 me qëllim të regjistrimit të regjistrin e prodhuesve bujqësorë, 1 me qëllim të regjistrimit në regjistrime të siguruarve, 3 mbi dëshminë e prejardhjes së parave, 2 kërkesa mbi dëshminë pranë organeve kompetente dhe 1 kërkesë për mungesë të paguar.

Është vendosur sipas Kërkesës sipas vlerësimit të ndikimit në ambientin jetësor në 1 rast- në bazë të programit IPARD.

Është refuzuar një kërkesë për shkak të dokumentacionit të paplotë sipas kërkesës për vlerësimin e ndikimit në ambientin jetësor, për shkak se e njëjta nuk është dorëzuar në afatin e paraparë.

Përfaqësuesit e Sekretariatit kanë marrë pjesë në sjelljen e Vendimit për dhënien e ndihmës subjekteve të cilat bëjnë grumbullimin e shalqirit si dhe lidhjen e kontratave në mes të Komunës së Tuzit dhe firmave që bëjnë grumbullimin. Pranë Red COMMERÇ është grumbulluar sasia totale e shalqirit prej 1.081,72 kg. Gjithashtu, gjatë sjelljes së Vendimit mbi ndihmën e subjekteve të cilat kryejn grumbullimin e tepricave të patates është marrë pjesë si dhe në lidhjen e kontratave mes Komunës së Tuzit dhe firmës e cila bën grumbullimin. Pranë Red COMMERÇ është bërë grumbullimi i sasisë së patateve prej 748,5505 kg.

Kur flasim për sjelljen e Vendimit mbi përkrahjen e prodhuesve të qumështit në nivel mujor, është bërë subvencionimi i qumështit për korporantët sipas regjistrin i cili në mënyrë periodike fitohet (numri varion çdo muaj) nga ana e ministrisë kompetente. Është bërë pagesa e shumës totale prej 28.108,12 euro deri në shtator 2020 gjejësisht 0.02 euro për litër të qumështit.

Me rastin e sjelljes së Vendimit mbi subvencionimin e përkrahjes së korrjes së drithërave, kemi bërë ndarjen e përkrahjes për 38 prodhues të drithërave.

Lidhur me kompensimin e moshës, janë dhënë udhëzime ndaj palëve, është përgatitur dokumentacioni dhe i është drejtuar ministrisë në 19 raste.

Dhënia e pëlqimeve në ligje

Ky sekretariat ka përgatitur mendime dhe sugjerime në:

- Projektligji për Shërbimet e ujit
- Propozimi i planit të menaxhimit të pellgut Adriatik.
- Propozimi i Vendimit për përgatitjen e vlerësimit strategjik mjedisor për planin e rregullimit të përgjithshëm të Malit të Zi.

Marrëdhëniet punës

Është kryer procedura e marrjes dhe udhëzimit të një zyrtari në vendin e përshtatshëm të punës në tjetër organ.

Në sekretariat janë angazhuar tre zyrtarë në verifikimin e dijes dhe aftësimin, kanë marrë pjesë Komisioni i përbërë nga zyrtarët e sekretariatit.

Raport për procedurën administrative

Është hartuar raporti për procedurën administrative nga fushëveprimi. Nga fushëveprimi i këtij sekretariati dhe i njëjti i është drejtuar Kryeadministratori me qëllim të inkorporimit të tij në raportin e PA të atij organit.

Punët ekonomike dhe llogaritare

Janë kryer çështjet ekonomike dhe llogaritare nga fushëveprimi i këtij sekretariati e të cilat kanë të bëjnë me subvencionet, ndihmat, kërkesat, pagave dhe punëve të tjera në bashkëpunim me sekretariatet kompetente.

Plani kadrovik

Është hartuar plani kadrovik i sekretariatit, është dorëzuar lista e pagave e gjithashtu është kryer edhe procedura tjetër administrative, janë mbajtur kontaktet me organet kompetente shtetërore dhe institucionet nga fushëveprimi i sekretariatit.

Qasja e lirë e informacioneve

Nga kjo pikëpamje është sjellë Udhëzuesi për qasje të lirë të informacioneve dhe është caktuar personi përgjegjës për vendimmarrje sipas kërkesave për qasje të lirë të informatave. Në një rast është vendosur pozitivisht lidhur me një kërkesë të tillë.

Ndihmë qytetarëve

Është bërë përpunimi i dokumentacionit dhe janë plotësuar formular të nevojshëm për qytetarët të cilët kanë bërë dorëzimin e llogarive për subvencionime nga ana e ministrie kompetente.

Panairi i bujqësisë

Është planifikuar organizimi i panairit të bujqësisë për datat 11 dhe 12 dhjetor 2020. Mirëpo për shkak të gjendjes me Covid 19 panairi nuk është mbajtur.

Aktivitetet e tjera

- Është kryer trajnimi i krasitjes dimërore të frutave me vreshtarët nga treva e Komunës së Tuzit.
- Janë bërë dy shqyrtime publike për aktet të cilat i ka përgatitur ky sekretariat,
- Gjatë lokdownit komunal është bërë distribuimi i qumështit edhe i prodhimeve të tjera bujqësore të cilat kanë qenë donacione të prodhueseve dhe donatorëve të tjerë,
- Janë dhënë udhëzime profesionale ndaj qytetarëve nga kjo trevë të cilët merren me bujqësi
- Në bashkëpunim me administratën dhe sigurimin e ushqimit, veterinarisë dhe punëve fito sanitare është bërë ndarja e 10 kontejnerëve për grumbullimin e ambalazheve me përbërje kimike për mbrojtjen e bimëve,
- Është në proces organizimi i kursit për përdorimin profesional të mjeteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu është bërë ndarja e 86 lejeve për prodhuesit të cilët në periudhën e mëparshme me sukses kanë ndjekur kursin,
- Me kërkesë të prodhuesve bujqësore janë lëshuar vërtetimet të cilat u lejojnë plasmanin prodhimeve bujqësore gjatë kohës së ndalimit të qarkullimit,
- Gjatë vitit 2020, është marrur pjesë në trajnime online të APK e të cilat kanë të bëjnë me qasjen e lirë të informacioneve si dhe me vlerësimin e nëpunësve dhe zyrtarëve.

6. DREJTORIA PËR NDËRTIM, PRONË DHE PËRFAQËSIM

Realizimi i funksioneve të Drejtorisë

1. Punët normative

Funksioni normativ i Drejtorisë është mbështetur në përpilimin e propozim vendimit mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësimin e plotë të patundshmërive në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë kishës katolike në Tuz, në pajtim me aktvendimin gjeneral urbanistik, Rregullores mbi ndryshime e Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim, Udhëzuesit të brendshëm për procedim sipas lëndëve në sektorin për përfaqësim dhe Udhëzuesit të brendshëm mbi mënyrën e udhëheqjes së evidencës dhe regjistrimin e pronës në pronësi të Komunës së Tuzit.

2. Punët pronësoro - juridike

Në bashkëpunim me Sekretariatën për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale janë realizuar punët në vijim: është dorëzuar kërkesa drejt organeve kompetente shtetërore për shpalljen e interesit publik në parcelat kadastrale në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë kishës katolike në Tuz, janë hartuar elaboratet e shpronësimit të parcelave kadastrale të cilat gjenden në trasenë e drejtimeve rrugore Tuz-Hot dhe Tuz-Mataguzh.

Në kartelin e parë të vitit 2020 është përgatitur raporti mbi gjendjen e pronës së Komunës së Tuzit.

3. Punët e përfaqësimit

Njëra nga kompetencat themelore të Drejtorisë është përfaqësimi i palës pra Komunës e duke u gjendur në këtë pozitë Drejtoria është e detyruar të siguroi dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme, që në të gjitha anët dhe profesionalisht i studioi marrëdhëniet problematike dhe në mënyrë efikase dhe kualitative të përfaqësoi interesat e Komunës, me ç' rast rroli përfaqësues i këtij organi veçanërisht vjen në shprehje në proceset gjyqësore.

Ndërsa kryesisht zhvillohen procedurat para gjykatave dhe organeve kompetente administrative në të cilat Drejtoria, përkatësisht përfaqësuesi i saj i autorizuar paraqitet në përfaqësimin e një pale kryesisht të pandehur të Komunës së Tuzit, afati i përfundimit dhe dinamika në raste varet nga gjykatat dhe organet para të cilave zhvillohen procedurat.

Në vitin kalendarik 2020, shumica e çështjeve gjyqësore nuk kanë përfunduar, disa çështje janë në Gjykatën Themelore në Podgoricë, si dhe në Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, një çështje është në Gjykatën Administrative të Malit të Zi, një numër më i vogël i çështjeve janë ankesat në pritje të Gjykatës së Lartë të Podgoricës, Gjykatën e Lartë në Bijelo Pole.

Procedimet janë duke u zhvilluar para Gjykatës Themelore në Podgoricë në 18 çështje, dhe 3 procedime janë duke u zhvilluar para Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi.

Vëmë re se ka një numër të konsiderueshëm të rasteve nga viti kalendarik 2019, të cilat nuk janë përfunduar, kështu që të gjitha janë renditur si raste në proces për vitin kalendarik 2020.

Struktura e çështjeve gjyqësore është e larmishme dhe gjithëpërfshirëse, e parë si tërësi e marrëdhënieve që janë duke u zgjidhur, institutet e shumta të së drejtës civile dhe reale, si dhe marrëdhëniet të detyrueshme.

4. Punët administrative

Në periudhën raportuese, Drejtoria lëshoi gjithsej 27 vendime për të cilat vendosi për çështje administrative, përkatësisht nga shërbimi civil - marrëdhëniet e punonjësve 6 vendime, qasja e lirë në informacion 2 dhe vendimet për emërimin e organit mbikëqyrës 19.

Bashkëpunimi me organet tjera

Drejtoria ka krijuar bashkëpunim me organet dhe shërbimet në nivelin e Komunës së Tuzit, si dhe bashkëpunim me organet shtetërore dhe organet dhe shërbimet e vetëqeverisjeve të tjera lokale.

Transparenca në punë

Drejtoria është plotësisht e përkushtuar në realizimin e parimeve të publikimeve dhe transparencës së punës së organeve të vetëqeverisjes lokale. Në këtë drejtim, duke respektuar parimin e dhënë, të gjitha vendimet, udhëzimet e brendshme, rregulloret, njoftimet, etj. janë publikuar në faqen e internetit të Komunës së Tuzit.

Organizimi dhe aftësia kadrovike

Detyrat e Drejtorisë shpërndahen në kuadër të Sektorit për ndërtim, Departamentit të pronave dhe Departamentit për përfaqësim. Në ditën e dorëzimit të këtij raporti, dy persona janë të punësuar në Drejtori, përkatësisht Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit (i emëruar për një periudhë prej 6 muajsh) dhe një punonjës PLP në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

Përfundimi dhe propozimi i masave

Duke pasur parasysh faktin se procedura për ndarjen e pronës midis Kryeqytetit të Podgoricës dhe Komunës së Tuzit ende nuk ka përfunduar, Drejtoria nuk ishte në gjendje të vazhdojë me zbatimin e një numri kompetencash në fushën e pronës.

Gjatë vitit 2021, procedura e përmendur pritet të përfundojë, kështu që në këtë drejtim, do të jetë e nevojshme të rritet numri i punonjësve të Drejtorisë në mënyrë që të kryejë me efikasitet detyrat brenda kompetencës së saj.

7. „KOMUNALNO – KOMUNALE” SHPK

Baza e raporteve dhe vlerësimeve të treguesve individualë për zbatimin e programit të shërbimeve për vitin 2020 bazohet në të dhëna të përcaktuara nga programi, si dhe të dhëna mbi zbatimin e të gjitha shërbimeve dhe njësisive të punës të Shoqërisë, të cilat janë planifikuar të jenë formuar, por kjo nuk ndodhi për shkak të problemit të lartëpërmendur.

Programi përcakton mirëmbajtjen e zonave publike, mbledhjen e grumbullimit dhe asgjësimin të mbetjeve, mirëmbajtjen e zonave të gjelbërta publike, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, shërbimet e tregut, funksionimin e strehëzave të qenve, mirëmbajtjen e lumenjve dhe rrjedhave të ujit, si dhe mirëmbajtjen emergjente të rrugëve gjat dimrit, sinjalizimi horizontal dhe vertikal dhe punë tjera.

Programi u financua përmes buxhetit të Komunës së Tuzit, nga donacionet, si dhe nga fondet vetanake.

Financimi i programit tonë u bë përmes mjeteve të buxhetit të komunës së Tuzit dhe mjeteve të vetë shoqërisë nga mbledhja për shërbimet e kryera duke filluar nga nëntori, kur pagesat filluan të bien.

Gjatë vitit 2020, Shoqëria arriti të ruajë një cilësi të mirë të punës brenda kompetencës së saj, pagat e rregullta të punonjësve, investimet materiale në pajisje dhe automjete në përputhje me kapacitetet e saj.

Faktorët kryesorë që komplikuan aktivitetet e rregullta të Shoqërisë janë mospërmbyshja e ndarjes me kryeqytetin si dhe financimi i blerjes së pajisjeve të nevojshme nga themeluesit.

Gjatë vitit 2020, Shoqëria nuk arriti të zbatojë programin e pritur të aktiviteteve të parashikuara për shkak të problemeve të mësipërme, gjithashtu duhet theksuar se duke marrë përsipër shërbimet e pastrimit, klientët tanë ishin skeptikë në pagesën e të arkëtueshmeve. Pra, ai skepticizëm ishte vendimtar për përqindje të vogël të realizimit të pagesave deri në fund të vitit 2020.

Pamundësia e mbledhjes dhe asgjësimit të mbetjeve jo-komunale, si dhe mos përcaktimi i vendeve për asgjësimin e mbetjeve të ndërtimit dhe bimore nga autoriteti kompetent i themeluesit, mbeti problem edhe në vitin 2020, pavarësisht nga disa përpjekje të vetëqeverisjes lokale për ta zgjidhur këtë problem, gjë që komplikoi Shoqërisë mundësitë e asgjësimit cilësor të këtyre llojeve të mbeturinave.

Problem i veçantë jo vetëm për komunën tonë, por edhe në të gjithë territorin e Malit të Zi është problemi i mbledhjes, deponimit dhe asgjësimit të mbetjeve të gomave. Për shkak të kësaj situatë, nuk mund të parandalonim rritjen e sasive të depozituara të këtyre llojeve të mbeturinave përreth vendeve për kontejnerë. Ministria e linjës dha propozime që ky depozitim të kryhet nga deponia sanitare "Livade", gjatë vitit 2020, procedura e ndërtimit të objekteve në vendin e përcaktuar si një sistem i centralizuar për të gjithë territorin e Malit të Zi nuk ka përfunduar. Pritet që ky problem të zgjidhet përgjithmonë në vitin e ardhshëm, për të cilin është e nevojshme të planifikohen burimet financiare për asgjësimin e këtij lloji të mbeturinave.

Në përputhje me nenin 9 të Statutit të Shoqërisë, Shoqërisë i është deleguar kryerja e veprimtarive komunale si vijon:

- Mbledhja mbeturinave të parrezikshëme, si aktivitete dominante, në Ligjin për Klasifikimin e aktiviteteve të përcaktuara në sektorin E, zona 38, dega 38.1, grupi 38.11
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike
- Mbledhja, transporti dhe deponimi i mbeturinave komunale për nevoja të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe
- Mbledhja dhe tregtimi i lëndëve sekondare

Shoqëria kryen veprimtari komunale, të parashikuara me Ligj për klasifikimin e aktiviteteve ("Fleta Zyrtare e MZ", numri 18/11) si veprimtari dominuese si vijon:

36 –Grumbullimi, pastrimi dhe furnizimi me ujë,

37 –Deponimi i ujërave të zeza,

38.11, 38,21, 38,32 –ripërdorimi i materialeve mbetëse,

39 –Pastrimi i mjedisit dhe aktivitete të tjera në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,

81,3 –Shërbimi i mirëmbajtjes

Veprimtari nga paragrafi 1 i këtij neni janë aktivitete me interes publik.

Pajisjet dhe flota e automjeteve

Shoqëria, si pajisje posedon një sharrë elektrike me zinxhir të markës Stihl, 1 sharrë për prerje të gjelbërimit, 10 makinë prerëse, një kositës dore dhe një ventilator për gjethe. Për sa i përket flotës së automjeteve, Shoqëria aktualisht posedon një makinë për mbeturina Mercedes të huazuar nga ndërmarrja komunale Budva, një makinë mbeturinash të huazuar nga ndërmarrja komunale Herceg Novi dhe një grajfer Mercedes i cili është marrë me qera, si dhe një makinë për mbeturina që është marrë me qera nga ndërmarrja komunale Ulqin.

Nga investimet, në vitin 2020 Shoqëria investoi në automjete që ishin më të nevojshme për Shoqërinë, që është një automjet i veçantë për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale (kamion mbeturinash) në vlerë prej 24,197,00 €. Automjeti u ble nga donacionet e dhuruara për Shoqërinë nga diaspora.

Udheheqësia e Shoqërisë u bëri ftesë të gjithë të punësuarve, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara, të japin kontributin e tyre të plotë në realizimin objektivave të miratuara.

Ne kemi arritur të përmirësojmë:

- Kënaqësinë e shfrytëzuesve të shërbimeve tona dhe palëve të tjera që janë të interesuar

- Shkallen e arritjes së qëllimeve të Shoqërisë, veçanërisht ato që lidhen me nivelin e proceseve, shërbimeve dhe organizimit në tërësi
- Nivelin e cilësisë së shërbimeve dhe efektet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe të punës
- Partneritetin, besimin e vetëqeverisjes lokale dhe shoqërisë në tërësi dhe rritja e numrit të shfrytëzuesve të shërbimeve tona
- Rezultati financiar për të investuar në njohuri, teknologji dhe pajisje të reja
- Kënaqësia e punonjësve dhe kontributi i tyre në realizimin e këtyre qëllimev

Shërbimi i pastrimit

Dispozitat e Nenit 19 të ligjit mbi veprimtaritë komunale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi« numri055/16,074/16,002/18,066/19) dhe neneve 9 dhe 10 të vendimit për rendin komunal (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 033/19 nga data 14.08.2019), si dhe me nenin 9 të Statutit të SHPK "Komunalno / Komunle" Tuz, kuvendi Komunal i Tuzit, (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 039/19 nga data 24.09.2019), përshkruajnë detyrimin për të hequr dhe asgjësuar mbeturinat shtëpiake dhe këtu konsiderohen të gjitha mbeturinat e ngurta të krijuara në ndërtesat e banimit familjar dhe ambientet e biznesit, të cilat për nga madhësia e tyre mund të hidhen në kontejnerë të mbeturinave shtëpiake - kontejnerë si dhe materiale të djegura-hirit).

Është krijuar një marrëdhënie me klientët dhe përdoruesit tjerë:

KATEGORIA	NUMRI I SHFRYTËZUESVE
Familjet-Amvisërit	2525
Afaristët, institucionet dhe sipërmarrësit	225

Detyrat e ruajtjes së pastërtisë së hapësirave publike dhe largimi i mbetjeve komunale nga ato zona kryhen nga "Komunalno / Komunale" Tuzi, dhe detyrat e ruajtjes së pastërtisë në zona të tjera kryhen nga persona juridikë dhe fizikë që administrojnë ose përdorin ato zona. . Grumbullimi i mbeturinave për këta persona kryhet nga Shoqëria në bazë të faturave ose kontratave.

Programi nga viti 2020 parashikon mirëmbajtjen, pastrimin , pastaj dinamikën dhe mënyrën e ruajtjes së pastërtisë publike, largimin dhe asgjësimin e mbetjeve komunale dhe mbetjeve të mëdha nga zona e qytetit dhe periferisë që përmban shumën e përafërt të fondeve për zbatimin e këtij programi. Siç është planifikuar, grumbullimi i mbeturinave kryhet në deponinë sanitare "Livade". Bashkëpunimi u krijua me një marrëveshje ku një faturë i dorëzohet Shoqërisë sonë në fund të çdo muaji. Grumbullimi i mbeturinave ndjek dinamikën e parashikuar. Qendra e qytetit dy herë në ditë, vendbanimet një herë në ditë, ndërsa për personat juridikë ata shkojnë me ftesën e tyre ose sipas nevojës, ndërsa pastrimi i mbetjeve të mëdha pastrohet një herë në javë ose sipas nevojës.

Në mënyrë të përmbledhur, Shoqëria është e angazhuar në aktivitetet e mëposhtme:

- Grumbullimi, asgjësimi dhe deponimi i mbetjeve komunale dhe mbetjeve të tjera artificiale (mbetje ndërtimore dhe mbetje makinash, etj.) nga vendet publike dhe private.
- Pastrimi dhe larja e hapësirave publike,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve, zonave të gjelbërta publike dhe rekreative: mbjellja e pemëve, barit dhe bimësisë tjetër, kositja e barit dhe prerja e pemëve, mirëmbajtja, pajisja dhe restaurimi i materialit bimor,
- Grumbullimi i kufomave të kafshëve të ngordhura nga vendet publike dhe largimi i tyre, si dhe largimi i automjeteve të dëmtuara dhe të braktisura nga vendet publike. Zonat publike përfshijnë: rrugë,

rrugica, shtigje për këmbësorë dhe biçikleta, sheshe, mbikalime dhe nënkalime, shkallë që lidhin zonat e transportit publik, stacione taksi dhe ndalesa, parkingje, shëtitorë, sheshe, lëndina, gjelbërim përgjatë rrugëve, zona përreth ndërtesave të banimit, kënde lojërash për fëmijë, parqe dhe parqe pyjore, zona të gjelbërta dhe zona zhytjesh, porte dhe brigje të peizazhit.

Ky shërbim zotëron një kamion mbeturinash "Mercedes", i cili u huazua nga komuna e Budvës për përdorim të mëtejshëm si dhe një kamion mbeturinash i huazuar nga JP "Čistoća" Herceg Novi. Nga donacionet, Shoqëria bleu një kamion mbeturinash Volvo. Individë privatë, të cilët posedojnë ekskavatorë dhe kamionë, gjithashtu angazhohen për të pastruar deponitë e egra, duke mirëmbajtur dhe pastruar qytetin tonë.

Dinamika e mirëmbajtjes së hapësirave publike në regjimin e verës dhe dimrit sigurohet plotësisht, si dhe për të gjitha ngjarjet dhe festimet kryesore.

Frekuenca e pastrimit të zonave publike në pjesën e qendrës së qytetit sigurohet duke punësuar 2 punëtorë në zona publike në regjimin jashtë sezonit, dhe 3 punëtorë në qendër të qytetit gjatë periudhës së verës së vitit 2020. Për mirëmbajtjen e hapësirave publike në periferi dhe zonat rurale, u punësuan 12 punëtorë që vazhdimisht ruanin pastërtinë, si dhe zonat e gjelbra publike.

Mirëmbajtja mekanike e hapësirave publike u krye në përputhje me kërkesat e policisë komunale dhe nevojave të treguara për shkak të hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve nga qytetarët, të ftuarve dhe subjekteve të biznesit.

Pastrimi i rrugëve përfshin: grumbullimin manual të mbeturinave, pastrimin me një automjet të veçantë, asgjësimin dhe deponimin e mbetjeve komunale, të tjera natyrore dhe artificiale (heqja e pjesëve të mobiljeve të hedhura, , degë, rrënoja, etj.), pastrim dhe larje të hapësirave publike .

Për nevojat e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit të mbeturinave, u morën në punë gjithsej 3 automjete speciale, 1 kamion, 1 makineri ndërtimore.

Një total prej 1,085.66 tonë mbetje komunale u depozituan në deponinë sanitare Livade, të cilën ne e depozituam nga tetori 2020 deri në dhjetor 2020.

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve lokale, varrezave dhe hapësirave publike

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve lokale, varrezave dhe hapësirave publike, ka bërë punët në mirëmbajtjen dhe rregullimin e zonave të gjelbërta publike përmes mirëmbajtjes së pemëve, gardheve, lëndinave, krasitjeve, hapjen e gropave, mbrojtjes dhe përpunimit të fidanëve, kositjes manuale dhe mekanike të zonave, si dhe largimi i mbetjeve nga zonat e gjelbërta.

Zonat e gjelbërta që mirëmban rregullisht ky shërbim janë:

- Parku në qendër të qytetit
- Shtrati i lumit Urrela
- Burimi Vitoja
- Burimi Krevenica
- Ubla në Milesh

➤ Aktivitetet e mirëmbajtjes së varrezave përfshijnë:

- Heqja e gjetheve të thara,
- Largimi i luleve dhe mbetjeve të tjera,
- Kositje dhe shkulje bari,
- Prerja e shkurreve dhe bimësisë tjetër,
- Fshirja e krosive.

Problemet kryesore në veprimtaritë gjatë vitit 2020 bazohen në zgjidhjen e mjedisit të punës, që nënkuptohet krijimin e kushteve të punës, prokurimin e makinerive të nevojshme dhe uljen e detyrimeve aktuale afatshkurtra, me nevojën për të ruajtur likuiditetin aktual dhe për të paguar pagat.

Mjetet e planifikuara për Shoqërinë tonë në formë të transferimeve nga buxheti i komunës së Tuzit në vlerë prej 100,000.00 €, të cilat sipas parashikimeve tona në atë periudhë ishin të pamjaftueshme për të ruajtur likuiditetin në vitin 2020. Më pas, nga ribalanci i buxhetit Komunal, Shoqërisë iu ndanë 20,000.00 € shtesë.

Si një ndërmarrje fillestare, është e nevojshme të gjejsh një model efikas të funksionimit, kur kjo të realizohet, atëherë ky model do të jetë efektiv. Për të arritur objektivat e lartpërmendura, është e nevojshme që themeluesi të sigurojë burime financiare dhe materiale, dmth. pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave që i janë deleguara nga kontrata për kryerjen e veprimtarive.

Gjatë vitit 2020, ndërmarrja punësoi kompani private me pajisje, të cilat nuk i posedon, për të ruajtur pastërtinë e qytetit, pastërtinë e zonave të gjelbërta dhe publike, shtretërit e lumenjve dhe rrjedhat e ujit, si dhe heqjen e deponive të paligjshme dhe të përkohshme.

Ne u detyruam të ulnim në minimum shpenzimet e planifikuara, me programin e punës për vitin 2020, domethënë t'i rregullonim ato me fondet e siguruar nga buxheti i themeluesit. Kjo pabarazi midis buxhetit dhe mjeteve të nevojshme nuk duhet të bëhet praktikë, sepse një trajtim i tillë i vazhdueshëm do të lëkundë likuiditetin në planin afatgjatë.

Mosbalancimi i deklaruar i mjeteve të nevojshme, financimi real i programit dhe mbledhja e ulët për shërbimet e ofruara, ndikuan në akumulimin e borxheve ndaj furnitorëve (Kapitulli IX). Për shkak të ndarjes së porealizuar me Kryeqytetin, dhe për shkak të çmimit të lartë për deponimin e mbeturinave, Shoqërisë i vështirsohet ndjeshëm puna dhe funksionimi normal.

Investimet e planifikuara nga Programi i punës për vitin 2020 dhe letrat e shumta drejtuar Komunës në lidhje me realizimin e tyre, ne besojmë se është e nevojshme të realizohen të paktën investime themelore dhe projekte sipas përmbajtjes së planifikuar në mënyrë që të sigurohet infrastruktura e nevojshme për kryerjen e veprimtarive komunale në Komunë.

Si pjesë e krijimit të kushteve të nevojshme për punën e ndërmarrjes së re, është e nevojshme që vitin e ardhshëm të zbatohet plotësisht kontrata mbi delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale midis themeluesit dhe ndërmarrjes si një detyrim ligjor i vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjes, themelues i të cilit është, dhe e cila kryen veprimtaritë komunale.

Sistemi i parregulluar i hedhjes së mbeturinave, veçanërisht për mbetjet ndërtimore dhe mbetjet e gjelbra, si dhe për mbetjet inerte, shkaktoi akumulimin e herëpashershëm të këtyre llojeve të mbeturinave në vende publike, si rezultat i të cilave u detyruam të kryenim një numër aktivitetesh në sanimin e vendeve për hedhjen e mbeturinave.

Mospërputhja financiare midis nevojave të programit dhe mjeteve të siguruar për realizimin e tij në pjesën e shpenzimeve të përbashkëta komunale, dhe praktika tashmë e vendosur e zvogëlimit të konsiderueshëm të mjeteve të alokuara sigurisht që ndikuan në shkallën e vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

8. ORGANIZATA TURISTIKE

Aktivitetet promovuese

Gjatë vitit 2020, Organizata turistike e Tuzit kur bëhet fjalë për komunën tonë, vendosi bazat për zhvillimin e ardhshëm në fushën e turizmit. Fokusi gjatë vitit të kaluar ishte në promovimin e komunës, kështu që komuna u promovua përmes mediave: revista të specializuara për turizëm, shfaqje televizive që merren me turizëm, si dhe pjesëmarrje të tjera në media. Gjithashtu, OT e Tuzit mori pjesë në hartëzimin e pasurive kulturore në komunë, në organizatën e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale.

Informacioni i turistëve

Në mënyrë që të gjithë të interesuarit të vizitojnë ose të zbulojnë diçka në lidhje me pikat turistike në komunën tonë, për të marrë informacionin e dëshiruar, në rrjetet sociale filloi një promovim dhe u krijua harta e parë e qendrës së Tuzit me rrethinat e saj.

Valorizimi i trashëgimisë kulturore

OT e Tuzit ka përgatitur një draft të promovimit dhe është planifikuar realizimi i promovimit të lokacionit Qaf Kishë për vitin 2021.

Organizimi i ngjarjeve

- Organizata Turistike e Tuzit organizoi Panairin e Artizanatit më 5 korrik të vitit 2020. Qëllimi i këtij panairi ishte promovimi i vlerës së artizanatit si një produkt unik dhe krijues, si dhe valorizimi i potencialit turistik të Tuzit.
- Në bashkëpunim me OJQ-në Oaza 2000, është organizuar panairi i parë i produkteve dhe ushqimeve tradicionale në Triesh me 11 tetor.
- Festivali i vjeshtës, i ushqimit dhe artizanatit i quajtur "Kungull Fest", u mbajt më 31 tetor.
- Ekspozita e Ardhjes, qirinjeve dhe kurorave, u mbajt në 15 nëntor.

Aktivitete të tjera

- OT e Tuzit, më 26 qershor, në bashkëpunim me SHPK „Komunalno / Komunale” Tuz, organizuan një punëtori në kopshtin e fëmijëve Gjina Vrbica, në Tuz, me temën e mbrojtjes së mjedisit. Organizata turistike u dhuroi fëmijëve dhe punonjësve mbajtës.
- Publikoi dhe zbatoi një thirrje publike për zgjedhjen e kopshtit më të bukur në Tuz.
- Publikoi thirrjen publike për zgjedhjen e logos zyrtare të OT të Tuzit.
- Publikoi thirrjen publike për furnizuesit e ushqimit për pjesëmarrje në broshurën e parë gastro të Tuzit.
- Në bashkëpunim me OJQ-në Alb Progres, u realizua faza e parë e pastrimit dhe promovimit të rrugës për këmbësorë Traboin – Grzoj.
- Janë bërë 10 stenda për nevojat e ngjarjeve të organizuara nga TO Tuz.

9. KLUBI I FUTBOLLIT „DEÇIQ“

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në aspektin e lojtarëve dhe kuadrit profesional për ekipin e seniorëve si dhe të kategorive të reja kishim prurje të mjaftueshme të lojtarëve dhe trajnerëve të cilët ishin të domosdoshëm për realizimin e objektivave të parapara.

Gjatë vitit 2020 për skuadrën e seniorëve, stafin profesional e kemi përforcuar me 2 trajner dhe një fizioterapeut, përderisa për kategoritë e reja i kemi angazhuar 5 trajnerë si dhe për ekipin B një trajner.

Në mënyrë cilësore dhe në kohën e duhur i kemi zhvilluar përgatitjet e dimrit në Ulqin, Janar - Shkurt 2 module nga 7 ditë si dhe përgatitjet verore 7 ditë në Mojkovcë.

Administrata e klubit paralel me punën e stafit teknik ka punuar në kompletimin dhe hartimin e dokumentacionit dhe Kontratës për financim dhe menaxhim të klubit futbollit Deçiq me të cilën është siguruar qëndrueshmëria e klubit dhe është sjellë një siguri për të gjithë akterët e interesit në klub. Gjithashtu me qëllim të funksionimit më efikas janë angazhuar dhe 2 punëtorë në administratë si dhe 10 përfaqësues të klubit të cilët janë të domosdoshëm për zhvillimin e ndeshjeve në të gjitha seleksionet.

Pandemia e shkaktuar nga virusi korona e ka ndërprerë kampionatin dhe ka vështirësuar punën e klubit, por me punë profesionale dhe me ndërgjegje kemi realizuar objektivin e paraparë, hyrja në ligën e parë. Duhet theksuar se gjatë kësaj kohe pandemie KF „Deçiq“ ishte klubi i vetëm në regjion i cili respektoi obligimet ndaj lojtarët, stafit profesional si dhe të punësuarve.

Edhe pse para kohet është ndërpre kampionati dominimi ynë gjatë gjithë sezonit nuk u vu në pyetje.

Gjithashtu gjatë kësaj kohe është punuar dhe asistuar në hartimin e projekt dokumentacioneve dhe punëve përgatitore për projektin e reflektorëve me vlerë prej 640.000,00 euro të cilat u vendosen në gushtë të vitit 2020.

Administrata e klubit ka ndihmuar në hartimin e dokumentacionit për tribuna dhe terreneve ndihmëse.

Gjatë gjithë vitit janë zhvilluar aktivitete për mirëmbajtjen e fushës së futbollit dhe ambienteve të klubit. Duhet theksuar se rrethanë e vështirë ishte edhe Vendimi i „Sportski objekti” SHPK nga Podgorica për ndërprerjen e mirëmbajtjes së fushës së futbollit dhe ky vendim na ka sjell shpenzime shtesë.

Janë angazhuar dy punëtorë për mirëmbajtje të terrenit kurse nga ana tjetër është bërë pajisja me mekanizime: cilindri për rrafshimin e terrenit, makinën shpuarje, pompa për mbrojtje terrenit, është vendosur elektropompa për ujitje si dhe ripërtëri pompat për ujitje. Gjithashtu, disa herë gjatë vitit 2020 është bërë stërpikja e barit me të gjitha standardet si dhe në fund të vitit është bërë edhe konservimi i terrenit.

Sa i përket kuadrit të lojtarëve të ekipit të seniorëve janë bërë përf forcime cilësore. Ekipit të klubit janë bashkëngjitë 10 lojtarë të cilët i kanë dhënë kontribut të madh sukseseve tona. Gjithashtu kujdes të veçantë i është kushtuar edhe kategorive të reja në të cilat janë themeluar dhe 4 seleksione dhe kështu është rrumbullakuar struktura e të gjitha seleksioneve sipas standardeve të Fifa-s dhe Uefa-s. Në këto seleksione ushtrojnë mbi 200 fëmijë dhe të rinj nga treva jonë dhe më gjerë. Për tu dhënë rastin lojtarëve që dalin nga skuadra e juniorëve dhe të tjerëve të cilët në këtë moment nuk i plotësojnë kërkesat për skuadrën e parë kemi themeluar dhe skuadrën B në të cilën ushtrojnë 25 lojtarë.

Kujdes i madh i është kushtuar dhe arsimimit të trajnerëve ku gjatë vitit 2020 u është mundësuar arsimim dhe trajnim profesional për 6 trajnerë të cilët kanë marrë licencën C, B dhe A.

Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve përgatitore është siguruar pajisja e domosdoshme sportive dhe rekuizitat për funksionim normal të klubit. Janë siguruar veshja sportive për të gjithë seleksionet, mbi 100 topa futbollit dhe pajisje tjera ndihmëse për punë në formë të topave varëse, shirita gome, piramida etj.

Gjithashtu gjatë përgatitjeve, janë forcuar kapacitetet në administratë për përgatitje dhe organizimin e ndeshjeve me ç’ rast gjatë vitit 2020 janë organizuar gjithsej 211 ndeshje (garuese dhe kontrolluese).

Si rezultat i punës së mirë dhe cilësore u arritën rezultate historike, rikthimi në ligën e parë CFL, kualifikimi në gjysmëfinale të Kupës së Malit të Zi si dhe kualifikimi në vendin e 2-të në gjysmësezonën e parë të ligës së Malit të Zi.

Me qellim të grumbullimit të mjeteve për funksionim më të mirë të klubit kryetari bëri vizitë në nëntor në SH.B.A me ftesën e shoqatave të diasporës.

Gjithashtu kemi punuar në hartimin e planit të punës dhe planit financiarë për vitin 2021.

Gjatë vitit 2020 janë mbajtur 3 mbledhje të Kuvendit të klubit si dhe 5 mbledhje të Këshillit drejtues.

IV. SHËRBIMET PROFESIONALE

1. SHËRBIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Përveç se Shërbimi i kryetarit të komunës dhe njësitë organizative të tjera të administratës lokale, kanë punuar në hartimin e dispozitave dhe akteve të tjera të cilat sjellë kryetari i komunës si dhe në përgatitjen e vendimeve dhe dokumenteve të tjera të cilat miratohen në kuvendin e komunës, është përcjellë realizimi i akteve të sjella nga ana e kryetarit të komunës dhe trupave punues, janë shqyrtuar propozimet dhe ankesat e qytetarëve. Është bërë caktimi dhe pranimi i palëve tek kryetari i komunës dhe është vepruar sipas kërkesave dhe propozimeve të cilat organet shtetërore i drejtojnë kryetarit të komunës.

Shërbimi i kryetarit ka përgatitur dhe ka organizuar kolegji me dhe takime të kryetarit të Komunës me përfaqësuesit e administratës lokale, sipërmarrësit, institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera, njëkohësisht ka bërë evidentimin e pranimit të palëve dhe ka caktuar takime me kryetarin e Komunës, kurse varësisht nga natyra e kërkesave të palëve janë drejtuar në bisedime edhe tek drejtuesit e organeve të tjera dhe shërbimeve kompetent për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Gjatë vitit 2020 është instaluar program i veçantë në ueb faqen <https://tuzi.org.me/donate/> i cili mundëson bashkimin e fondeve në rrjetë, i cili është i dedikuar për zhvillimin e PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE në Malësi.

Përveç faqes zyrtare, komuna ka profile në rrjetat sociale të cilat sot janë mjete të rëndësishme për komunikimin me qytetarët. Çdo aktivitet i komunës është e azhurnuar në faqet e Facebook-it dhe Instagram-it, në mënyrë që qytetarët të njihen me aktivitetet e vetëqeverisjes lokale dhe të kenë mundësinë të japin propozime dhe sugjerime në drejtim të përmirësimit të funksionimit.

Një nga projektet më të suksesshme para vetë-izolimit, Komuna e Tuzit realizojë në bashkëpunim me Unionin e bashkive shqiptare në rajon, do të thotë manifestimi me rastin e 8 Marsit, ku u organizua Forumi i parë i grave shqiptare në rajon. Ky aktivitet filloi me hapjen e panairit të artizanatit, i cili paraqiti mbi 40 ekspozuese nga 8 Komuna, me ç'rast morën pjesë të gjitha SHKA-të nga Malësia. Panairi u hap nga kryetari i komunës së Tuzit, i cili në fjalën e tij përshëndetëse shprehu kënaqësinë që mund të presë ekspozuese gra, të cilave u uroi Ditën ndërkombëtare të gruas. Kjo ngjarje kishte një rëndësi të madhe për komunën e Tuzit dhe ishte një kënaqësi e madhe që ishim mikpritës të këtij manifestimi, me të cilin së bashku promovuam kulturën tonë. Ajo ditë ishte një mundësi unike për të treguar respekt dhe kujdes për gratë dhe rolin e tyre të pazëvendësueshëm në zhvillimin e shoqërisë, duke mos harruar që ato meritojnë respektin tonë çdo ditë të vitit. Në këtë drejtim, në Ditën ndërkombëtare të gruas, përveç panairit ekzistues, organizuam një panel diskutimi mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike, ekonomike dhe publike në rajon, i cili u mbajt në sallën e Kuvendit të komunës së Tuzit. Paneli nën moton „Gratë e suksesshme në rajon” ishte një mundësi për pjesëmarrësit në diskutim për të diskutuar dhe prezantuar pozicionin aktual të grave në jetën shoqërore dhe politike. Unionin e bashkive shqiptare në rajon meriton mirënjohje të veçantë për mbështetjen dhe bashkëpunimin në organizimin e kësaj ngjarje, me synimin për të vazhduar aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen për të promovuar dhe zhvilluar kulturën tonë. Vlen të përmendet një mysafire speciale me rastin e kësaj ngjarje, dhe bëhet fjalë për kryetaren e komunës së Tetovës, Teuta Arifi, e cila është edhe nënkryetare e Unionit në fjalë.

Komuna e Tuzit, duke bashkëndjerë momente të vështira me Amerikën, popullin amerikan, me familjet e viktimave dhe të prekurit nga kjo pandemi, në ndërtesën e vet, ka shpalosur flamurin e shtetit të SHBA-ve, me ç'rast kemi shprehë solidaritetin me të thellë me SHBA-të dhe popullin amerikan! Gjithashtu, Komuna e Tuzit me rastin e „28.Nëntorit” Ditës së flamurit dhe Ditës së pavarësisë së shtetit të Shqipërisë në ndërtesën e vet, ka shpalosur flamurin e shtetit shqiptarë.

Në bashkëpunim me agjencinë ADvantage, në „Delta City ”, u organizua panairin e shtatë tradicional -„Më të mirat nga Mali i Zi”. Në këtë panair morën pjesë prodhues të ushqimeve, pijeve tradicionale si dhe punimeve të dorës nga i gjithë Mali i Zi, ku, sigurisht që morën pjesë edhe prodhuesit nga Komuna e Tuzit, të cilët për vizitorët, ekspozuan prodhimet dhe punët e tyre tradicionale vendase - „Më të mirat nga Tuzi”. Produktet vendase dhe agroturizmi zënë një vend të veçantë në ekonominë lokale, prandaj, si shtysë, Komuna e Tuzit vendosi, që për prodhuesit e vet të sigurojë pesë stenda.

Komuna e Tuzit iu bashkëngjiti Marrëveshjes së kryebashkiakëve për klimën dhe energjinë. Në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit më datën 29.12.2020. votuan të gjithë këshilltarët pro, për bashkëngjitjen e Marrëveshjes së kryebashkiakëve për klimën dhe energjinë. Ky vendimi është rezultat i programit Interreg CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi. Në pyetje janë projekte LEC - Komunitetet e qëndrueshme të energjisë lokale dhe ADRIA_Alliance - ALIANSA ndërkuftare për promovimin e efikasitetit energjetik dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të financuara nga Bashkimi Evropian. Marrëveshja e kryebashkiakëve paraqet lëvizjen më të madhe në botë dhe lidhet me aktivitetet e klimës dhe energjisë në nivelin lokal. Kjo Marrëveshje bashkon rreth 9.000 vetëqeverisje lokale nga 57 vende të botës të cilat janë të përkushtuara për realizimin e qëllimeve të BE (Bashkimit Evropian) për klimën dhe energjinë. Vizioni i kësaj lëvizje lidhet me vitin 2050 dhe i referohet dekarbonizimit, forcimit të kapacitetit për tu përshtatur me ndryshimet klimatike, ndikimi i të cilave është i pashmangshëm, dhe kështu lejon që banorët të kenë energji të sigurt dhe të qëndrueshme.

Gjatë vitit 2020, u zhvilluan takime midis kryetarit të komunës dhe nënkryetarëve, në këtë mënyrë u organizua takimi me kryetaren e Komisionit për politikën e jashtme të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, me përfaqësuesit e qyteteve karnavale të Malit të Zi, pjesëmarrës në manifestimin kulturor „Karnavali-Koret” në Tuz. Gjithashtu, u mirëpritën sportistët, Angjella Berishaj dhe Zinedin Beqaj nga klubi i taekwondo-së „Besa” të cilin përfaqëson trajneri Nikollë Gegaj, të cilëve u dha shpërblimi me vlerë prej 500.00€ për secilin, si përkrahje për sukseset e arritura deri tani në këtë sport. Përkrahje të tilla financiare për talentet e rinj në fushën e sportit dhe jo vetëm, vijnë si motivim dhe mbështetje për ata, që në të ardhmen të përgatiten akoma më shumë e që të kemi përfaqësime edhe më dinjitoze.

Kryetari i komunës së Tuzit së bashku me nënkryetarët ka pasur kënaqësi të mirëpresë Zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Malit të Zi, Z. Dritan Abazović i cili ishte i shoqëruar nga Ministri i Financave Z. Millojko Spajiq dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Z. Jakov Millatović. Z. Abazović, vlerësoi këtë takim si tejet të rëndësishëm, ku theksoi se kjo ishte edhe vizita e parë zyrtare e tij në postin e Zëvendëskryeministrit në të cilin takim u dakordësuan projekte të rëndësishme të cilat do të përmirësojnë dukshëm cilësinë e jetës së qytetarëve.

Komuna e Tuzit ka të krijuar sistemin për Qasje të lirë në informacion. Çdo njësi organizative ka një udhëzues për Qasje të lirë në informacion, dhe ka emëruar personin e autorizuar për Qasje të lirë në informacion. Në përputhje me sa më sipër, 7 kërkesa për Qasje të lirë në informacion iu drejtuan shërbimit të kryetarit. Janë sjellë 4 aktvendime me të cilat kërkesa është miratuar, si dhe 3 njoftime, dy për informacionin në dispozicion të publikut dhe një njoftim për paraqitjen e kërkesës tek një organ tjetër. Në aktvendim të Shërbimit të kryetarit është dorëzuar një ankesë.

Prokurimet publike

Zyrtarët e prokurimit publik kryejnë detyrë në lidhje me planifikimin e prokurimit publik të mallrave, punëve dhe shërbimeve, kryerjen e procedurave në përputhje me Ligjin e prokurimit publik, përgatitjen e planeve mujore dhe vjetore të prokurimit publik, përgatitjen e raporteve të prokurimit publik për organin kompetent të prokurimit publik shtetëror, si dhe detyra të tjera brenda përshkrimit dhe detyrës së punës.

Për sa i përket transparencës së sistemit, Komuna e Tuzit mori rezultatin më të lartë në vitin 2020 kur bëhet fjalë për disponueshmërinë, kohën dhe transparencën e të dhënave të prokurimit publik. Të dhënat për planet e miratuara dhe ndryshimet në planin e prokurimit publik, si dhe për procedurat e zbatuara të prokurimit publik ishin në dispozicion gjatë gjithë vitit si në Portalin e prokurimit publik ashtu edhe në faqen e internetit të Komunës së Tuzit.

Meqenëse trajnimi profesional është një nga format më të rëndësishme të forcimit të burimeve njerëzore të pjesëmarrësve në sistemin e prokurimit publik, personat që kryejnë prokurime publike në Komunën e Tuzit ndoqën disa trajnime në internet përmes një aplikacioni zoom të organizuar nga Drejtoria për politikën e prokurimit publik si dhe Administratës për burimet njerëzore me qëllim të njoftimit me dispozitat e Ligjit të ri të prokurimit publik.

Duke pasur parasysh që programi i trajnimit dhe certifikimi i zyrtarëve është segment shumë i rëndësishëm dhe kusht për kryerjen e detyrës dhe punëve në përputhje me ligjin, gjatë vitit 2020 dy zyrtare që punojnë punët e prokurimit publik kanë përfunduar provimin profesional dhe tani Komuna e Tuzit ka 3 zyrtare që posedojnë licencën për kryerjen e punëve të prokurimit publik.

Plani i Prokurimit Publik i Komunës së Tuzit për vitin 2020, i cili u miratua në 20.01.2020, arriti vlerën prej 1.945.234,0 €, për prokurimin e mallrave 58.240,00 €, për prokurimin e punëve 1.363.863,00 € dhe për prokurimin e shërbimeve 523.131,00 €. Plani u ndryshua 9 herë gjatë vitit 2020, ku një prej ndryshimeve kishte të bënte me përputhjen e Planit të prokurimit me Ligjin e ri të prokurimit publik.

Në vitin 2020, komuna e Tuzit, lidhi 8 kontrata të prokurimit publik duke përdorur procedurat e prokurimit publik në vlerë prej 875.150,19 €, për prokurime me vlerë të vogël ose prokurime të thjeshta 33 kontrata me vlerë 576.082,07 €, ndërsa për prokurime urgjente 6 kontrata me vlerë 178.973,21 €

Numri i procedurave, prokurimeve me vlerë të vogël nga 01.01.2020 në 07.07.2020 është 26 numri i prokurimeve të thjeshta të kryera nga 07.07.2020 deri më 31.12.2020 është 7, prokurime urgjente 6, numri i procedurave të kryera duke përdorur procedurë të hapur është 8 dhe një procedurë e negociuar pa publikim paraprak të thirrjes për tender.

Llojet e procedurave të prokurimit publik (vlera dhe pjesa në vlerë)			
Procedura të hapura	Prokurim në vlerë të vogël/Prokurime të thjeshta	Prokurime urgjente	Procedurë e negociuar pa publikim paraprak të thirrjes për tender.
784.496,23 €	576.082,07 €	178.973,21 €	90.653,96 €
48,12 %	35,34 %	10,98 %	5,56 %

Procedurat e hapura të Komunës së Tuzit gjatë vitit 2020, kanë të bëjnë me prokurimin e:

1. Shërbimet televizive në gjuhën shqipe;
2. Karburanti;
3. Rindërtimi i rrugës për në Kojë;
4. Rindërtimi i rrugës në Dinoshë nga dyqani deri tek xhamia sipas Projektit Kryesor;
5. Rishtrimi i rrugës Vuksanlekaj - Sukruq;
6. Rishtrimi i rrugës Vuksanlekaj - Nënhelm;
7. Punimi i Projektit Kryesor për rindërtimin e urës në Zharnicë;
8. Asfaltimi dhe tamponimi i rrugëve në BL në komunën e Tuzit.

Të gjitha procedurat u kryen brenda periudhës së parashikuar dhe në përputhje me ligjin, pa ankesa nga ofertuesit, përveç procedurës për prokurimin e shërbimeve - Punimi i Projektit Kryesor për rindërtimin e urës në Zharnicë, për të cilën u dorëzua një ankesë kundër Vendimit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme. Vendimi i ri për zgjedhjen e ofertës më të favorshme u bë me propozimin e Komisionit për mbrojtjen e të drejtave për procedurat e prokurimit publik, derisa kontrata e prokurimit publik me ofertuesin e renditur në rang të parë dhe të saktë duhet të lidhet brenda afatit të përcaktuar me ligjin.

Për herë të parë gjatë vitit 2020, Komuna e Tuzit zhvilloi një procedurë negocimi pa një ftesë paraprake për tender për prokurimin e librave shkollorë për të gjitha klasat e shkollës fillore në vlerë prej 90,653.96 €.

Për më tepër, duke pasur parasysh situatën në lidhje me virusin Covid-19 në territorin e komunës së Tuzit dhe se banorët e komunës sonë ishin të ndaluar të lëviznin dhe të linin shtëpitë e tyre nga 24.03.2020 deri më 21.04.2020, zyrtarët e prokurimit prokurimit kanë kryer 6 prokurime urgjente për prokurimin e produkteve ushqimore, paketave të tjera, higjienës për fëmijë si dhe karburantit për funksionimin e rregullt të këshillit të komunës dhe vullnetarëve gjatë kësaj periudhe.

Të gjitha procedurat u kryen në përputhje me ligjin dhe rregulloret dhe u publikuan të njëjtën ditë në portalin e prokurimit publik dhe në faqen e internetit të Komunës së Tuzit.

Megjithëse punonin në kushte të vështira, zyrtarët e prokurimit publik lëshuan leje për secilin ofertues dhe kryen normalisht dhe me sukses procedurat e mëposhtme siç vijojnë:

1. Paketa me produkte ushqimore;
2. Prokurimi i vezëve për Pashkë;
3. Pako për Pashkët;
4. Prokurimi i higjienës dhe ushqimit për fëmijë;
5. Prokurimi i karburantit për funksionim të rregullt;
6. Prokurimi i bukës për nevojat e komunës së Tuzit.

Në fund të fundit, procedurat që janë kryer me sukses si prokurim me vlerë të vogël gjegjësisht si prokurim i thjeshtë nga data 07.07.2020 deri më 31.12.2020, kanë të bëjnë me prokurimin si më poshtë:

1. Shërbimet e qiradhënies së objekteve për nevojat e Komunës së Tuzit;
2. Marrja me qira e lokaleve në qendër të Tuzit;
3. Mirëmbajtja e vazhdueshme e pajisjeve - automjeteve;
4. Prokurimi i automjeteve zyrtare për nevojat e Policisë komunale;
5. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softverit;
6. Shërbimet e pllenimit të mushkonjave;
7. Material për zyre dhe materiali tjetër administrativ;
8. Tamponimi dhe asfaltimi i rrugës Delaj - Poprat;
9. Tamponimi i rrugës për në Kojë;
10. Tamponimi i rrugës Vuksanlekaj - Sukuruq;
11. Tamponimi i rrugës Vuksanlekaj – Nënhelm;
12. Tamponimi dhe asfaltimi i rrugës për në shkollën në Kshevë;
13. Zhvillimi i një projekti për rregullimin teknik të trafikut;
14. Mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugëve komunale dhe të pa kategorizuara;
15. Rindërtimi i rrugës Rrogath – Milesh i sipërm;
16. Prokurimi dhe instalimi i mobileve komunale;
17. Prokurimi i fidanëve për zonat e gjelbra;
18. Modernizimi, asfaltimi i rrugëve komunale dhe të kategorizuara;
19. Ndërtimi i terreneve për lojëra për fëmijë në komunën e Tuzit;

20. Ndërtimi dhe rindërtimi i infrastrukturës lokale pranë kopshtit në Tuz;
21. Rregullimi i infrastrukturës lokale në Priften dhe Selishtë;
22. Mirëmbajtja e rrjetit rrugor në pjesën malore;
23. Punimet e ndërtimit pranë pusit në Mësh;
24. Zhvillimi i Projektit Kryesor për rindërtimin e rrugës Podgoricë - Tuz në pjesën nga ura e Zharnicës deri në kthesën për Shipçanik;
25. Punimi i Projektit kryesor për Rindërtimin e Tribunës në Stadiumin KF Deçiq;
26. Përgatitja e studimit të shpronësimit Mataguzh - Tuz;
27. Punimet e instalimit elektrik në ndriçimin publik;
28. Shërbimet e telefonisë mobile;
29. Shërbimet e mirëmbajtjes së ndriçimi publik;
31. Punimet për ndërtimin e një terreni sportiv në Mësh;
32. Punimet në infrastrukturën lokale dhe instalimin e një rrethimi mbrojtës;
33. Rregullimi i infrastrukturës lokale në Pikalë dhe Lofkë;
34. Reprerentacioni dhe harxhimet tjera për bufe.

Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe projektet

Bashkëpunimi ndërkombëtar i komunës së Tuzit në vitin 2020 karakterizohet nga aktivitetet dhe tërheqje të fondeve të konsiderueshme përmes fondeve IPA, veçanërisht në pjesën që lidhet me bashkëpunimin ndërkufitar Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi. Me realizimin që zgjati 18 muaj, ka filluar implementimi i dy projekteve, projekti LEC - Energji të qëndrueshme për komunitete lokale me vlerë 717.904,35 euro, nga të cilat 191.495,59 euro do të implementohen nga komuna. Rezultatet më të rëndësishme të projektit do të jenë Plani i përbashkët për efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e qëndrueshëm të energjisë, si dhe projekti pilot në Shkollën e mesme „25.maj” për të ndryshuar të gjitha dyert dhe dritaret.

Projekti i dytë nga ftesa e përmendur Adria_Alliance - Aleanca ndërkufitare adriatike për promovimin e efikasitetit të energjisë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në rolin e partneri, Komuna e Tuzit do të implementojë aktivitetet me vlerë 107.009,75 euro. Theksi vihet në zhvillimin e SECAP - Plani i veprimt për energji të qëndrueshme dhe klimën si dhe zbatimin e projekteve pilot për efikasitetin e ndërtesave publike, për komunën e Tuzit është blerja dhe instalimi i kaldajave të peletit në Shkollën fillore „Mahmut Lekiq”. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha informacionet në lidhje me projektet publikohen në mënyrë transparente në rrjetet sociale të komunës, gjithashtu, secili projekt ka faqen e tij në Facebook-ut. Pjesë e fillimit të aktiviteteve të këtij projekti është bashkëngjitja në Marrëveshjen e kryebashkiakëve e cila është lëvizja më e madhe në botë dhe lidhet me klimën dhe aktivitetet e energjisë në nivelin lokal. Kjo marrëveshje bashkon disa qindra qeveri lokale të përkushtuara për arritjen e qëllimeve të BE-së për klimën dhe energjinë. Flitet për një mbledhje të më shumë se 9.000 vetëqeverisjeve lokale nga 57 vende të botës. Informacione më të hollësishme mund të gjenden në ueb faqen e komunës në pjesën që lidhet me projektet.

Komuna e Tuzit, në kuadër të projektit Evropa për qytetarët, partner në projektin A4EUS - Aksioni për solidaritetin evropian, zbaton aktivitetet „soft” siç janë organizimi i konferencave në internet dhe xhirimi i një filmi të shkurtër për të huajt që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në Qendrën e pritjes në Bozhaj dhe do t'u paraqitet partnerëve gjatë vitit 2021. Vlora e të gjithë projektit është 146.160 mijë, nga të cilat rreth 1.500 euro do të ndahen për aktivitetet komunale. Si pjesë e thirrjes për Evropa për qytetarët, komuna aplikoi me një projekt me Unionin e bashkive shqiptare në rajon me një projekt në lidhje me rrjetëzimin e qyteteve për një trashëgimi të përbashkët kulturore. Gjithashtu, projekti i dytë, i cili u aplikua brenda të njëjtës thirrje, i referohej përmirësimit të aktiviteteve të bibliotekës në QIK „Malësia”.

Kur flasim për donacionin POPOS në Ambasadën e Japonisë, për blerjen e kamionëve për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, projekti nuk u pranua. Përfaqësuesit e Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar të Shërbimit të kryetarit zhvilluan një takim me përfaqësuesit e TIKA-s, me rastin e aplikimit për të njëjtin projekt me titull „Menaxhimi i mjedisit dhe depozitimi i mbeturinave në Komunën e Tuzit”, duke pasur parasysh se pritet përgjigje pozitive, në vitin 2021 do të realizohet projekti i cili do të jetë një kontribut i madh për shërbimet komunale në komunën tonë.

Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar drejt ministrive kompetente ka aplikuar me projekte për prokurimin dhe instalimin e kontejnerëve nëntokësorë si dhe prokurimin e kamionëve me vet ngarkim për ngritjen e kontejnerëve nëntokësorë, dhe projekti i dytë ka të bëjë me rregullimin e shtratit të lumit Urrëla për programimin për IPA 2021 dhe IPA 2022 në nivelin shtetëror.

Në kuadër të thirrjes WBIF – Korniza investuese perëndimore, komuna ka aplikuar për një projekt që tashmë është në Listën e unifikuar të projekteve me prioritet dhe i referohet fazës së dytë të projektit Modernizimi hekurudhor Podgoricë - Tuz - Tiranë, gjithashtu një projekt që duhet implementuar nga niveli shtetëror.

Duhet të theksohet prokurimi i pajisjeve për Shërbimin e mbrojtjes dhe shpëtimit të ardhshëm të Komunës së Tuzit në qershor 2020, dorëzimi i pajisjeve për zjarrfikësit mes pronarit të firmës BEDROCK shpk dhe një përfaqësuesit të komunës së Tuzit. Pajisjet janë rezultat i një projekti të zbatuar përmes shpërndarjes së mjeteve nga Fondi për mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2019, të cilat ndahen nga Ministria e punëve të brendshme të Malit të Zi.

Duhet të konkludohet se me krijimin e zyrës së veçantë është theksuar bashkëpunimin ndërkufitar, i cili sigurisht është qëllimi i shtetit të Malit të Zi në rrugën e integritit evropian. Duhet të theksohet se Komuna e Tuzit, nga statusi i saj si komunë urbane deri në statusin e një komune të plotë, tregon rezultate të konsiderueshme në aktivitetet e projektit dhe tërheq fonde. Ne jemi në një grup të komunave që janë shumë të suksesshëm në të gjitha fushat e bashkëpunimit ndërkufitar, burimet njerëzore janë trajnuar në këtë mënyrë dhe të gjithë qytetarët e komunës së Tuzit përfitojnë, gjë që sigurisht është qëllimi i thirrjeve të tilla. Gjithashtu është i rëndësishëm bashkëpunimi me ambasadat dhe misionet e tjera të huaja, të cilat tregojnë interes për komunën e Tuzit.

2. SHËRBIMI I KRYEADMINISTRATORIT

Me nenin 77 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale dhe nenin 118 të Statutit të komunës së Tuzit është e përcaktuar që Kryeadministratori: kryen punë të organit të shkallës së dytë në çështje administrative nga kompetencat e organit dhe shërbimeve të posaçme; koordinon punën e organeve dhe shërbimeve, në kryerjen e punëve për të cilat është i nevojshëm bashkëpunimi reciprok (përgatitja e rregullave, planeve aksionare, plani strategjik për zhvillimin e Komunës së Tuzit dhe planeve dhe programeve tjera zhvillimore, përgatitjen e raporteve për realizimin e tyre dhe materialit profesional dhe informativ, raportin për realizimin e ligjit, rregullave të Komunës së Tuzit etj.); jep mendimin në aktin me të cilin konstatohet organizimi dhe mënyra e punës e administratës së Komunës së Tuzit; jep këshilla profesionale dhe instruksione për punë organeve dhe shërbimeve, për arsye të realizimit e rregullt të ligjit dhe rregullave tjera; përgatit raportin vjetor mbi veprimin në çështjet administrative nga kompetencat e Komunës së Tuzit; i dorëzon kryetarit të Komunës raportin vjetor mbi punën dhe raportet tjera në kërkesë të kryetarit të Komunës; zgjidh konfliktin e kompetencave në mes të organeve të administratës së Komunës së Tuzit dhe konfliktin e kompetencave në mes të organeve të administratës lokale të Komunës dhe organeve të administratës së Komunës së Tuzit; kryen punë të tjera të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Tuzit dhe akte të kryetarit të Komunës.

Procedura e zgjidhjes administrative në procedurën e shkallës së dytë kryhet në përputhje me zbatimin e Ligjit për procedurën administrative si dhe zbatimin e dispozitave të veçanta procedurale të përshkruara nga dispozita të caktuara ligjore. Procedura e zgjidhjes administrative si në shkallën e parë ashtu edhe në atë të shkallës së dytë ndikohet ndjeshëm nga zbatimi i rregulloreve të tjera që lidhen me efikasitetin dhe kohën e duhur në zgjidhjen e çështjeve administrative, duke vepruar në përputhje me rregullat e procedurës dhe të ngjashme.

Vështrimi i procedurave administrative të shkallës së dytë (zgjidhja administrative)

Gjatë vitit raportues, janë regjistruar gjithsej 24 ankesa, nga të cilat:

- Miratuar 19 brenda afatit ligjor,
- Refuzohet 1 brenda afatit,
- Procedurat në tre raste u pezulluan (pala e tërhoqi ankesën), dhe
- Një ankesë mbeti e pazgjidhur (ankesa u paraqit më 31.12.2020 dhe e njëjta u zgjidh, d.m.th. u refuzua brenda afatit ligjor)

Procedura administrative e shkallës së parë brenda kompetencës së kryeadministratorit

Procedurat e shkallës së parë u zhvilluan në 6 raste, si më poshtë:

- 5 kërkesa për qasje të lirë në informacion, të cilat janë miratuar brenda afatit ligjor dhe
- 1 kërkesë për zgjidhjen e konflikteve të kompetencave (zgjidhur brenda afatit ligjor)

Punë të tjera

- Në 4 raste, kërkesa iu përcoll organit kompetent dhe pala u njoftua, ndërsa organi kompetent nuk e informoi shërbimin e Kryeadministratorit për masat dhe veprimet e ndërmarra;
- Plani i kuadrove për vitin 2021 u përgatit dhe iu paraqit Sekretariatit për financa për aprovim;
- Me kërkesë të Unionit të komunave të Malit të Zi në 3 raste u dhanë mendime për projektligjet;
- Me kërkesë të kryetarit, u dha një mendim për Projektvendimin mbi ndryshimet dhe plotësimet të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit;
- Është sjellë Udhëzuesi për qasje të lirë në informacion dhe një formë e përshkruar e kërkesave për qasje të lirë në informacion brenda kompetencave të Kryeadministratorit;
- Është sjellë Programi vjetor i punës së Shërbimit të kryeadministratorit;
- Kryetarit të Komunës iu paraqit një propozim për trajnimin e stafit të organeve dhe shërbimeve komunale, në mënyrë që të kryejë në mënyrë më efektive dhe detyrat brenda kompetencave të saj.

Dhënë pëlqimet në Programet e punës për vitin 2021:

1. Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim
2. Sekretariatit për vetëqeverisje lokale
3. Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale
4. Administratës së të ardhurave lokale publike
5. Shërbimit të policisë komunale dhe inspektionit komunal

V. SHËRBIMET E VEÇANTA

1. SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT KOMUNAL

Shërbimi i policisë komunale dhe inspektionit komunal kryen detyrat e përcaktuara me Vendimin mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit.

Për periudhën në vitin 2020, veçanërisht janë rritur aktivitetet në lidhje me inspektimin e shtratit të lumit Cem për të parandaluar eksploatimin jo legal dhe shfrytëzimin e paligjshëm të zhavorrit dhe rërës, pastaj mbikëqyrja e shitjeve jashtë tregut rezultoi mirë dhe u arrit në bashkëpunim me Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale.

Në vitin 2020, shërbimi i policisë komunale dhe inspektionit komunal dukshëm zvogëloi numrin e makinave që ishin parkuar në mënyrë të paligjshme në rrugët e Komunës së Tuzit.

Struktura e kualifikimit të punonjësve: me arsim të lartë - 4 dhe me arsim të mesëm - 8.

Në funksion të sa më sipër, Shërbimi i policisë komunale dhe inspektionit komunal ka filluar procedurat e mëposhtme në përputhje me kompetencat e veta:

- Numri i inspektimeve të kryera në bazë të kërkesave të qytetarëve: 15
- Numri i inspektimeve të kryera sipas detyrës zyrtare: 37
- Numri i procesverbaleve të bëra: 18
- Numri i vendimeve të miratuara: 0
- Numri i njoftimeve të dërguara: 520
- Numri i thirrjeve të bëra: 0
- Numri i urdhrave të lëshuar për kundërvajtje: 270
- Numri i raporteve të paraqitura për shkak të nënçimit të zyrtarëve: 0
- Numri i vendimeve për përmbarim: 0
- Disa inspektime u kryen në shtratin e lumit Cem për të mbrojtur dhe parandaluar shfrytëzimin e zhavorrit dhe rërës;
- Inspektorët komunalë përqendruan vëmendje të veçantë në kontrollin e vendimeve në orarin e punës;
- Orari i punës i ambienteve të hotelerisë kontrollohej në orët e para të mëngjesit, ditët e punës dhe fundjavat;
- Numri i njoftimeve të dërguara është 520, dhe i referohet lënies së njoftimeve në vetura që ishin në shkelje, me qëllim marrjen e rendit të kundërvajtjes, si dhe dërgimin e njoftimeve me postë, gjithashtu në mënyrë që të merret përsipër urdhri i kundërvajtjes;
- Për vitin 2020, janë lëshuar 270 urdhra për kundërvajtje, Shërbimi i policisë komunale dhe inspektionit komunal nuk ka të dhëna të sakta se sa gjoha janë paguar (bazuar në fletëpagesat), të paguara brenda 8 ditëve. Urdhrat e tjerë të lëshuar për kundërvajtje pas skadimit të 8 ditëve nga dita e dorëzimit marrin statusin e „borxhit në regjistër”, dhe pastaj pas një viti fitohet e drejta e pagesës së detyruar;
- Janë bërë kontrole që synojnë mbrojtjen e rrjedhave ujore të lumit Cem;
- Angazhimi i inspektorëve në pjesën që lidhet me tregun e gjelbër u rrit, si dhe në drejtim të largimit të dhjetëra personave që bënë shitje jashtë tregut, me qëllim që të paraqiten tek Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale.

VI. VLERËSIMI I PUNËS SË ADMINISTRATËS LOKALE DHE PROPOZIMI I MASAVE

Funksionimi i administratës lokale gjatë vitit 2020 kishte për qëllim sigurimin e punës ligjore dhe cilësore me zbatimin e metodave bashkëkohore dhe kontrollin dhe përgjegjësinë e vazhdueshme të punonjësve, të cilat kontribuan në atë që qytetarët të ushtrojnë në mënyrë më efikase dhe ekonomike të drejtat e tyre, por edhe përmbushjen e detyrimeve. Në vitin e pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID19, Komuna e Tuzit, përkundër faktit të karantinës në të gjithë territorin e saj për tre javë, zbatoi me shumë sukses masat e vendosura nga Trupi koordinues nacional për sëmundjet infektive dhe furnizoi qytetarët e saj me nevojat themelore dhe në të njëjtën kohë, në kushte të tilla organizoi funksionimin e qetë të organeve dhe shërbimeve administrative.

Në këtë raport duhet të përmendim patjetër se, gjatë këtij viti shumë të vështirë gjatë të cilit komuna u përball me një sfidë të paplanifikuar dhe të paparashikueshme të virusit COVID19, ajo përsëri arriti të bëjë investime shumë të rëndësishme të cilat, kryetari së bashku me nënkryetarët dhe bashkëpunëtorët e komunës brenda planeve të investimeve të komunës së Tuzit, arriti ti realizojë. Konkretisht u bë tamponimi i rrugës në drejtim të „Livadeve të Tuzit” në mes Bashkësive lokale Narhelm - Dreshaj dhe Sukruqit ku u bë tamponimi i rrugës në drejtim të Zbeqit në BL Sukruq dhe tamponimi i rrugës pranë varrezave në BL Milesh, (varrezave të dy fshatrave, Mileshit dhe Rrogathit).

Financiarisht në vlerë prej 15,000.00 €, u mbështet iniciativa e të rinjve nga Mileshi, ku kanë filluar punimet për ndërtimin e një kompleksi sportiv.

Pastaj, dy kontrata shumë të rëndësishme u nënshkruan me kontraktorët, përkatësisht: „Putevi Bar” shpk i cili bëri asfaltimin e rrugës për në Kojë në vlerë prej 123.420,00 €, si dhe me „Tehnoput MNE” shpk për asfaltimin e rrugës në Sukruq vlere e së cilës është 193.856,52 €, të dy investime që u përfunduan dhe përfunduar në vitin 2020.

Komuna e Tuzit ka bërë rikonstruktimin e infrastrukturës lokale pranë kopshtit dhe shkollës fillore në Tuz. Ky projekt në vlerë prej 7.547,93 € përfshin: Pastrimin e terrenit me zhveshje, për ndërtimin e trotuareve me gjerësi 120 cm, prokurimin dhe mbjelljen e barit, prokurimin dhe instalimin e sistemeve të ujitjes për zonat e gjelbra, prokurimin dhe mbjelljen e bimëve, pastrimin e terrenit dhe rrënojat, prokurimi dhe instalimi i stolave, si dhe prokurimi dhe instalimi i koshave të plehrave.

Është vazhduar me punime në stadiumin klubit të futbollit „Deçiç” dhe janë vënë reflektorëve në kuadër të projektit për rikonstruktimin e stadiumit. Investimet e tilla rrisin nivelin e këtij sporti sepse nuk mund të ketë zhvillim të futbollit elitari pa plotësuar së pari kushtet e nevojshme moderne dhe sipas standardeve evropiane.

Është bërë inaugurimi i shëtitores Vulaj-Tuz-Hakshabanaj, tashmë kjo zonë e kthyer në një hapësirë rekreative multifunkionale për të gjithë banorët e Malësisë. Gjithashtu, Komuna e Tuzit ka përfunduar një tjetër ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturën rrugore të vendit, e cila do ju vjen në ndihmë banorëve të fshatit të Kshevës. Në prag të fillimit të vitit të ri shkollor është bërë ndërhyrje në zgjerimin e një pjese të rrugës që çon te shkolla fillore e fshatit e gjitha kjo për të ju ofruar banorëve vendas, e në veçanti prindërve, fëmijët e të cilëve ndjekin mësimin në këtë shkollë, kushte më të mira infrastrukture.

Edhe një sukses tjetër si pjesë e planit të investimeve ishte hapja e rrugës që lidh tre fshatra, Vuksanaj - Dreshaj - Narhem. Gjegjësisht, është bërë asfaltimi i aksit rrugorë prej 3 km e gjatë, 5.5 m e gjerë, me vlerë 124.146,00 €, ndërsa kontraktuesi ishte „Tehnoput MNE” shpk.

Janë ndarë bursat për 7 studentët më të mirë të cilët janë përzgjedhë nga ana e Komisionit për ndarjen e bursave për vitin akademik 2019/2020 si dhe për 11 studentët më të mirë të cilët janë përzgjedhë nga ana e Komisionit për ndarjen e bursave për vitin akademik 2020/2021.

Gjithashtu, është iniciuar procesi i hartimit të Planit strategjik zhvillimor të komunës së Tuzit për periudhë 2020-2026.

U inaugurua përfundimi i asfaltimit të rrugës pranë xhamisë së Dinoshës, investim kapital shumë i rëndësishëm për infrastrukturën e Malësisë, me vlerë prej 178.343,48€, kontraktuesi „Avio Petrol” shpk. Ky projekt kapital është bërë me qëllim të krijimit të kushteve më të mira dhe lehtësimin e qarkullimit të lirë të banorëve të kësaj zone, përderisa investime të tilla infrastrukturore do vazhdojnë të jenë prioritet i veprimtarisë sonë edhe për vitin që vjen.

Në kuadër të bashkëpunimit me Unionin e bashkive shqiptare në rajon u mbajt mbledhja e organeve drejtuese të Unionit të bashkive shqiptare në rajon, pra mbledhja e Asamblesë së përgjithshme dhe Këshillit drejtues, mbledhje në të cilën morën pjesë kryetarët e komunave dhe bashkive anëtarë të unionit. Gjatë këtij takimi u shpalosen eksperiencat në lidhje me strategjinë e ndjekur deri tani për menaxhimin e mirë të kësaj situatës së krijuar nga virusit, COVID-19. Gjithashtu, filozofia e çdo komune dhe bashkie si dhe perspektivat e së ardhmes, mbi COVID-19, nevoja e ngritjes së emergjencave civile, ndërtimin e strukturave përkatëse të emergjencave civile rajonale të UBSHR-së në përgjigje të kësaj sfide ishin temat kryesore diskutimit në këtë takim. Ky takim vazhdoi me promovimin e projektit për zhvillimin e turizmit rajonal ku u diskutua mbi problematikat dhe dëmet që ka shkaktuar pandemia në turizmin rajonal, si dhe strategjitë e ndërmarra për përballimin e krizës dhe zhvillimin e turizmit. Në këtë takim, gjithashtu u paraqit edhe projekti i rradhës i UBSHR-së që është krijimi i Forumit të parë të përhershëm për turizmin rajonal, i cili ka për qëllim mbështetjen e sipërmarrjeve turistike shqiptare në rajon.

Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, vizitoi punimet në rrugën Dinoshë – Cemi i Trieshit, dhe u shpreh i kënaqur me punën e deritanishme, duke e vlerësuar rëndësinë madhore që ka kjo rrugë ndërkombëtare. Ky aks rrugor lidh dhe ofron qytetarët nga komunat në veri të Malit të Zi, sidomos Plavës dhe Gucisë me Komunën e Tuzit dhe Kryeqytetin. Kjo rrugë gjithashtu zbulon bukuritë dhe atraksionin e lumit Cem, duke u dhënë mundësi banorëve vendas që të zhvillojnë turizmin.

Duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodheshin prindërit, në mënyrë që të përgatitnin fëmijët e tyre për vitin e ri shkollor, Komuna e Tuzit bëri të mundurën që t'ua lehtësonte këtë barrë. Në këtë drejtim, janë siguruar mjetet për financimin e librave shkollorë për të gjithë nxënësit e shkollës fillore, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

Komuna e Tuzit gjithashtu vendosi lule në bustin e Mahmut Lekiq dhe në monumentin për ushtarët e rënë në Cem - Rakiq me rastin e „15 Dhjetorit – Ditës së çlirimit të Tuzit”.

Është e rëndësishme të përmendet se viti i kaluar u shënuar nga ngjarje të papritura në lidhje me pandeminë e virusit COVID 19. Përkundër kësaj, vetëqeverisja lokale prapë se prapë ka arritur rezultate në realizimin e detyrimeve të saj të përditshme kur bëhet fjalë për shërbimin ndaj qytetarëve.

Nr.01-031/21-3314

Tuz, 09.03.2021



Në bazë të nenit 53 paragrafi 1 pika 23 e Statutit të komunës së Tuzit („Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale” nr. 24/19, 05/20), Kuvendi i komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më _____.2021, pas shqyrtimit të Raportit të punës së kryetarit, organeve të administratës dhe shërbimeve të komunës së Tuzit për vitin 2020, ka sjellë

KONKLUDIM

MIRATOHET Raporti i punës së kryetarit, organeve të administratës dhe shërbimeve të komunës së Tuzit për vitin 2020.

Numër: 02-030/21-
Tuz, _____.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT
KRYETARI,
Fadil Kajoshaj